

Tabloja e parë

Një sallon i madh i një vile luksoze, plot me tavolina të mbushura me të gjitha të mirat, ku kanë zënë vend plot të rinj,që nuk lëvizin.

Menjëherë të krijohet përshtypja e një banketi festiv.

Nga njeri cep i paraskenës shfaqet "AI",një mesoburrë i veshur me kostum të zi, që, si bën disa hapa, u drejtohet shikuesve.

AI – Që të mblidhen një grup të rinjsh për të dëfryer mund të ketë, po edhe mund të mos ketë shkak.Mjafton një propozim i hedhur fare rastësisht dhe u bë, apo nuk është kështu? Ndërsa këtë radhë motivi është konkret. Klodi,ajo bukuroshja pranë magnetofonit mbush 18 vjet! E si mund të lihet një rast i tillë të kalojë pa tundur dyshtemenë nga vallzimi, pa kënduar të gjitha këngët që dihen e s'dihen mirë, pa harxhuar tërë arsenalin e shakave me ose pa kripë, pa çjerrur zërin nga thirrjet e të gjitha llojeve dhe pa një banket të tillë dinjitoz, ku nuk mungon asgjë, asgjë,që nga mishi i kaprollit e deri tek hurmat e Arabisë...Klodi e meriton një darkë të tillë, apo jo, aq më tepër, kur është edhe fëmija i vetëm i një personaliteti të tillë si shoku Rudi... Dhe, kështu pra, ajo ftoi disa nga miqtë e saj të shumtë,që, natyrisht,duhej të vinin çift.Berti (*tregon me gisht*) arkitekt në Institutin e projekteve solli të motrën; Gramozi, poet, që sapo ka botuar vëllim e parë me poezi, kushurirën; Ylli, mjek i ri psikiatër, të mbesën, Beni,shok i klasës një kushurirë,siç e prezantoi ai,gjë që fare mirë mund të vihet në dyshim nga mënyra tepër intime e vallzimit të tyre të shpeshtë, Mirela, shoqja e ngushtë, ka ardhur me Vilin,djalin e xhaxhait,student i vitit të fundit të inxhinierisë,që deri tani nuk ka vallzuar asnjëherë e kështu me radhë...

Tashti festa do të vazhdojë rrjedhën e saj të caktuar dhe do t'i hapë shtegun ngjarjesh që desha të rrëfej, në të cilën sipas rastit dhe ku ta shoh të nevojshme do të ndërhyj herë pas here.Mos je shkrimtari, mund të pyesni. Merreni si të doni, po unë në këtë ngjarje nuk kam emër konkret...

(Largohet.Rritet muzika ritmike që gjallëron të ftuarit)

KLODI – Siç ju thashë më parë,vallzimin këtë radhë do ta bëjmë në formë loje:Në letrat që ju shpërndava ju duhet të shkruani emrin e atij apo asaj që dëshëroni të vallzoni.Të shohim a përkojnë dëshirat...I shkruat? Hajde Arsen, mblidhi të gjitha letrat dhe lexoi...

(Arseni me shpejtë grumbullon letrat tavolinë më tavolinë dhe i lexon.)

ARSENI – Vetëm njera përputhet: Beni me Krisin!(*të qeshura*)

BENI – Ç'ka këtu për të qeshur

ARSENI – Se deri tani ke kërcyer nëntë herë me kushërirën tënde dhe nuk jeni ngopur ende!...

Beni – E pastaj?

Arseni – Pastaj, hiç,sikur thashë...(përsëri të qeshura) Të tjerët nuk kanë kombinuar.Katër kërkesa për ty, Klodi, që je në vend të parë me diferencë pikësh.

Klodi – Ngaqë kam ditëlindjen, prandaj...

Arseni – Sigurisht, sikur thashë...

Mirela – Lexoi emrat!

Arseni – Berti, Aleks, Gramozi dhe Ylli...

Mirela – Po Klodi, kë ka zgjedhur?

Arseni – Benin, po i shkoi hurç! (*Mirela qesh me të madhe*)

Beni – Ç’i zbardh dhëmbët? Po kot habitem, se mos di gjë tjetër!... (*Mirela qesh përsëri*)

Arseni – Po atëherë si t’ia bëjmë? Janë katër vetë, që presin në ankth..

Gramozi – Më takon mua, se Ylli e Berti kanë vallzuar me ty, Aleks i është më i ri, kështu që kuptohet vetvetiu...

Aleks i – Ta liroj rradhën me kusht, që tashti të thurësh katër vargje për Klodin.

Gramozi – Katër vargje the? Mirë, ja prisni pak...

Natyrë në flokët tuaj derdhi argjend

Deti në sytë – thellësinë,

Dielli – ngrohtësinë në shpirtin tënd

Dëbora në zemër – bardhësinë!

(*duartrokitje, thirrje “Të lumtë, të lumtë”*)

Aleks i – E ke hak, unë tërhiqem!

Berti – Unë jo. Së pari, se vargjet duhet t’i kesh patur të gatëshme..

Gramozi – (*e ndërpret*) Ju betohem, që ishin të çastit! Për kokë të nënës!

Berti – (*në të tijën*) Dhe së dyti, kjo radhë ishte e veçantë.. Ti fiton të drejtën për herën tjetër. Unë propozoj të hidhet me short... (*miratim*)

Arseni – Mirë, ja t’i përziem letrat!

Berti – Hileqar! Kujt do t’ia hedhësh ti?! Pse këtë të Gramozit e ndave veçmas?

Aleks i – Për korruptim dhe manipulim të votimeve i hiqet e drejta... Propozoj të jem unë... Dakord? Miratohet! (*përziem edhe një herë letrat dhe kap njerën*) Fiton Ylli!

(*duartrokitje*) E gëzofsh Ylli! Sa për të tjerët, jeni të lirë!

(*fillon muzikë. Mirela i afrohet Vilit*)

Mirela- Ngrehu, Vili, nuk ke vallzuar asnjëherë.

Vili – As që kam ndërmend...

Mirela – Pse, nuk ndjehesh mirë?

Vili – Mirë ndjehem, po s’më pëlqen... Ulu edhe ti, po të duash..

Mirela – (*ulet*) Po ç’ke ti, të vjen zor që nuk njihesh me ta? Qenke budalla!

Vili – Nuk dua t’ia prish stomakut!... Ku është mësuar, i shkreti me gjithë këto të mira!

Mirela – Ohu, ku të shkon mendja! Lëri këta, këta janë të lartë!... Ku hahemi me ta!

Vili – Po, po, e shoh! Kjo shoqja jote paska shumë kërkesa!

Mirela – Është vajzë shumë e mirë, Vili, e kam shumë shoqe... Ndoshta pak e përkëdhelur, po...

Vili – Sigurisht!... (*Hyn Nasta që sjell pije të tjera. Është rreth të pesëdhjetave, e heshtur dhe ecën ngadalë sikur ka frikë se mos thyen gjë*) Po kjo, kameriere apo shërbëtore?

Mirela – Je në vete?! Kjo është Nasta, një kushërirë e largët e shokut Rudi, nga Korça. Kishte mbetur vetëm, e shkreta, e pa martuar... Shokut Rudi, që është shpirt njeriu, i erdhi keq dhe mori të jetojë me to.. Ka një vit e gjysëm... S’paska dëgjuar?! Të gjithëve u ka bërë përshtypje të mirë...

(*Ylli, disi i prekur në sedër, vallzon me Klodin*)

Ylli – Nuk ma kishte marrë mendja kurrë, se dëshira ime e shkruar në letër për të vallzuar me ty, nuk do të përkonte me tënden...

Klodi – Të njëjtat fjalë mund të thonë edhe të tjerët...

Ylli – Përshembull Berti?

Klodi – Përshembull Berti, Gramozi, Aleksii...Ata, mbase edhe mund të qahen, kurse ti jo...

Ylli – Se mu realizua dëshira? Po a ka vlerë kur realizohet mbi shortin e një shorti?Këtë fat mund ta kishte edhe ndonjeri nga ata të tre...

Klodi – Po ja që të ra ty!Nuk mjafton kjo për të të larguar atë tis mërzie që të ka rrudhur vetullat, po të flisnim me gjuhën e Gramozit?

Ylli – Si do ta përshkruaje gjendjen time, po të flisje me gjuhën e Bertit?

Klodi – Nuk e di, jam e dobët në vizatim teknik!...Po, me siguri, do të përmendeshin ca prerje tërthore në fytyrë...Ndërsa, po të flisja me gjuhën tënde, është mirë, i dashur pacient, të largosh ca fiksasione që mund të kenë lindur...

Ylli – Përse e keni fjalën,doktor?

Klodi – Se po shkatërroni kot së koti ca qeliza trunore, që mund t’ju vlenin në të ardhmen...

Ylli – Klodi, e di, se luan bukur?

Klodi – Kam fatin të kem një kushuri nga mamaja që është baletmaestër...Por s’po më pëlqen muzika..t’u them ta ndrojnë?!

Ylli – Ti je e gjithëpushtetëshme...Mund të veprosh si të të duash... Bile edhe ta ndërpresësh fare...

Klodi – Jo, se muzika është e bukur, vetëm se duhet të jetë e kohës dhe larg anakronizmit, që të bezdis...

Ylli – Kurrë nuk po arrij të të kuptoj, Klodi...

Klodi – Dobësi profesionale...

Ylli – Këtu qëndron e keqja, se nga mjek jam kther në një pacient... Nuk të duket e çuditëshme?

Klodi – Aspak, gjëra që ngjasin...Nuk më takon mua të të këshilloj, por mbase ke nevojë për pak qetësi...E ke marrë me aq pasion punën atje në spital, sa ke kaluar në stërmundim...

Ylli – Ti mund të më ndihmoje për të gjetur qetësinë e humbur...

Klodi – Me kënaqësinë më të madhe...Është mirë ta ndihmosh tjetrin, kur ka nevojë, aq më tepër kur “ ky tjetri” është një miku yt i mirë...

Ylli – *(gjallërohet)* Vertetë e thua këtë?

Klodi – Pse ti e ve në dyshim, që të kam mik dhe do të bëj ç’është e mundur të të kthej qetësinë e humbur?

Ylli – Të faleminderit, që më në fund fillove të flasësh seriozisht!*(e sheh drejtë në sy)* Domethënë mund të shpresoj tek ti...

Klodi – Sigurisht! Ç’thua, sikur të bisedoj me babin për ty?! Një specialim në Francë nuk do të bënte keq...*(Ylli qesh idhshëm)*

(Dikush ndërpret muzikën.Të gjithë kthejnë kokat.Në sallën kanë hyrë prindërit e Klodit, Leta, një grua rreth të dyzetave, po shumë në formë dhe shoku Rudi, që të

imponon respekt me paraqitjen e tij hijerëndë, i cili ka vënë buzën në gaz. Reagim nga të pranishmit.)

Rudi – Përse e ndërpretë muzikën? Kështu bëhemi fajtorë unë dhe Leta...

Zëra – Jo, shoku Rudi, ju na nderuat!...

Rudi – Megjithatë nuk do t'u përzihemi! Ju jeni të rinj dhe keni dëshirat tuaja..Ne erdhëm veç t'ju falenderojmë dhe të ngrejmë një gotë me ju! Ç' thua, Nasta, sonte mund të bëj një përjashtim, apo jo?(*Nasta pa folur sjell dy gota dhe ua mbush*) Po tënden, ku e ke?Mos u bëj hileqare! Mbushe, mbushe edhe një për vete!E po, mirë se na erdhët dhe paçi veç gëzime (*I takon gotat me të gjithë*) Pa eja këtu, moj bijë!(*Yllit*)Doktor,vetëm sa ta uroj! (*E përqafton Klodin*)Njëqind vjeç,moj bijë! Qofsh e lumtur dhe u bëfsh e denjë për vete e shoqërinë!(*të gjithëve*)Gëzuar!(*atij që është te magnetofoni*) Ke ndonjë këngë popullore aty, apo nuk di shqip magnetofoni!..Nejse, nejse, meqë e paskeni te kasetat tjetër, nuk do t'u ha kohë...Kalofshi gëzuar!(*dalin*)

Rifillon gjallëria e ndërprerë,në fillim me përshpëritje, pastaj urojnë njeri tjetrin dhe ndeshin gotat.Ylli zë vend në tavolinën e tij.

Beni – (*Krisit*)Kam shumë vapë!...

Krisi – Edhe unë...

Beni - Dalim e freskohemi pak në oborr?

Krisi – Mirë! (*maten të dalin*)

Arseni – Ku shkoni ju?

Beni – Përjashta..të marrim pak ajër të pastër...

Arseni – Keni të drejtë..shumë vapë...

Beni – Vapë..Mos kishe gjë ti?

Arseni – Jo, ore, sikur thashë..Po vij edhe unë me ju...(*plas e qeshura*)

Mirela – (*me zë të lartë*)Arsen, mos dil, se dua të vallzoh me ty!...

Arseni – Ashtu?(*Benit*)Më fal, po s'ju shoqëroj dot!...

Beni – Sa keq!(*dalin*)

Muzikë.Klodi i afrohet tavolinës ku rri Vili.

Klodi – Më ka bërë shumë përshtypje, më falni se ju ua harrova emrin, kur na prezantoi Mirela...

Vili – Vili..

Klodi – Më ka bërë përshtypje,Vili,që gjatë gjithë kohës s'keni luajtur nga vendi as edhe një herë...Indiferent ndaj gjithçkaje!

Vili – Ju faleminderit për vëmendjen!...

Klodi – Është në detyrën time si zonjë shtëpie...Po a s'më thoni,çfarë i mungon kësaj mbrëmje, që të plotësojë kërkesat tuaja,që, me sa duket,duhet të jenë tepër të larta!...Dhe tek e fundit ç'qenkeni ju?

Vili – (*qetë*)Thonë se i gëzoj të gjitha atributet e një njeriu normal...

Klodi – (*e ngacmuar*)Vërtetë?Po gëzohem!

Vili – Ju faleminderit! Më vjen mirë që u lehtësuat!..

Klodi – (*hyn në lojë*)Të them të drejtën dyshova...Mos ju kanë sjellë gjë me zor?!

Vili - Pothuajse..Mu qep Mirela...

Klodi – Tjetër herë mos e bëni këtë gabim!

Vili – Do të përpiqem...Me gjithatë, po ju them se jo ndaj gjithçkaje jam treguar indiferent, siç mund të keni kujtuar...S'kam si ta mohoj gjënë më të mirë të kësaj mbrëmje, për mendimin tim...

Klodi – (*e mikluar*) Po e gjykuat të arsyeshme, a mund të ma shuani kureshtjen?

Vili – Nuk përbën sekret...E kisha fjalën për...mezet..Me të vërtetë të mira! Kurrë s'kisha ngrënë më parë mish kaprolli...Qenka shumë i shijshëm dhe ju e gatuekeni shumë mirë...

Klodi – (*e prekur*)Vërtetë, ju i paskeni boshatisur pjatat!..Me sa duket paskeni ardhur pa ngrënë darkë...(*me zë që ta dëgjojnë të gjithë*)Nasta, kjo tavolina këtu ka mbetur pa meze...

Vili – (*qetë*) I thoni edhe për nje teke raki!...

Klodi – (*me inat*) Edhe një dopio raki!(*Nasta i sjell me të shpejtë*) Tani që siguroat bazën ushqimore, a mund të vallzojmë bashkë?

Vili – (*qesh*)Më folët si zooteknike... Në Institutin e Kamzës e keni syrin?!

Klodi – (*që është zemëruar keqas, po nuk do të jepet*) Unë po pres...

Vili – (*në të tijën*)Më vjen keq, po nuk jua plotëoj dot dëshirën.Së pari. se sapo refuzova Mirelën, por edhe pse nuk dua të humbas asnjë çast nga kënaqësia ime e vetme për sonte..Natyrisht, nëqoftë se ju ngulni këmbë..

Klodi – Jo, jo,s'është nevoja! Çojeni deri në fund kënaqësinë tuaj!

largohet me të shpejtë e zemëruar, sa bie në sy të të gjithëve.Ylli e ka ndjekur bisedën.Klodit i afrohet Mirela.

Mirela – Ç'pate kështu?!

Klodi – Ç'është ky karrocier, që më ke sjellë?

Mirela – Kush,Vili karrocier?Ai na jep ujë të gjithëve në bisht të lugës! Studenti më i mirë i injinierisë...Unë të kam folur për të...

Klodi – Ai është karrocier!Një karrocier mendjemadh!..U bëra kaq dhe nuk më ka fyer kush si ai!Më prishi mbrëmjen! Po do ta shohë!...

Shuhen dritat.Në paraskenë shfaqet "Ai"

Ai – Zemërimi që rritej gjithnjë e më shumë, nuk e la Klodin të mbyllë sy atë natë...Në shpirtin e saj merrte përmasa gjithnjë e më të mëdha dëshira e hakmarrjes.Po si ta gjente rastin? E kishte ruajtur një ditë,si rastësisht, kur Vili po dilte nga fakulteti, që t'i provokonte përshëndetje, por ai e dalloj apo s'e dalloj, eja merre vesh, i kaloi pranë pa i dhënë fare të njohur...Zjarrit të urrejtjes, i qe hedhur benzina! Ruajna zot nga një zjarr i tillë!...

Tabloja e dytë

Pamje e brëndëshme e një kuzhine të thjeshtë, që për kushtet e familjes Rumina, shërben edhe si dhomë pritjeje. Tavolina e bukës diku në cep, mbuluar me një cohë ngjyrë të çelur. Në ballë është një bufë standarte e kohës, që është modifikuar edhe për të vendosur televizorin. Dy divanë, të bërë vetë, qëndrojnë përballë njeri tjetrit. Në mur një fotografi e zmadhuar e familjes prej gjashtë pjestarësh.

Dhoma është e pastër dhe e rregullt. Në njerin nga divanat është ulur Vili, që studion me disa libra të hedhur përreth tij. Nga dera në të djathtë del Lumja, e ëma, rreth dyzet e pesë vjeçe, që me gjithë thinjat e shumta e rrudhat në fytyrë ende ruan shenja të spikatura të bukurisë së saj të dikurshme.

Lumja vështron në dritare. Vili nge kokën dhe vë buzën në gaz.

Vili – Mbetë në dritare, nënë...

Lumja – Kështu e kam pritur gjithnjë e kështu do ta pres sa të kem frymë. Ke parë ti, se me kalimin e viteve kjo nevojë sa vjen e rritet? Ju keni sejcili udhën tuaj, Vasfiu më mbetet.

Vili – Domethënë, neve po na jepkeni rrugët!...Shumë egoiste, nënë!..

Lumja – Për shpirt, do të doja t'ua kisha të gjithëve rreth e rrotull, por jeta ka rregullat e veta, që nuk i shkel dot...

Vili – E ç' do të bëni, kur më në fund do të mbeteni vetëm?

Lumja – Do të na pushojnë veshët nga zhurmat e përditëshme, do të shplodhim kockat e lodhura, do të rrisim kolopuçët tuaj, që do të na e shtojnë jetën, pastaj do rrimë pranë njeri tjetrit, do të pimë ngeshëm kafe, do të t'ju presim e ju përcjellim...Kaç...Pse ç' dua më shumë nga jeta?!

Vili – Dhe me kaç shfaqja mbaroi..Natën e mirë! Cili do të ishte vlerësimi juaj përpara se të dilnit nga salla?

Lumja – Megjithëse e mundimëshme, ajo ishte e bukur, se kishte brenda shumë dashuri...

Vili – Pasojë e së cilës lindën katër fëmijë...

Lumja – Nuk ka rëndësi sa, por si rriten ata...Po qenë të mbarë, kafënë mund ta pish i qetë në pleqëri...

Vili – Prit, nënë, se ke kohë të mendosh për pleqërinë...Ti je si llokum!..

Lumja- E posi, nuk e sheh si jam zbardhur? Nuk është e lehtë të rritësh katër fëmijë me dy rroga punëtorësh...Mbaroje shkollën këtë vit, t'ia bëhesh krah tyt eti, se je më i madhi...Vëllain ushtar, motrat fare të reja..A nuk të duket se jemi ne mesin e shfaqjes?!..

Vili – Me këtë intelekt që ke, të paktën një drejtoreshë ndërrmarrjeje duhej të ishe...Si është e mundur që nuk u ke rënë në sy, xhanëm?E ç' rëndësi ka, që shkollën e mesme e ke marrë natën? Pse pak kuadro i kanë ngjitur shkallët e karrierës me kurajo, entuziazëm, vetmohim, edhe pse, rastësisht u ka munguar diploma. Tani janë bërë aq të mënçur, aq të kulturuar, sa dinë të lexojnë edhe raportet që u përgatisin të tjerët, bile të bëjnë edhe vërejtje kompetente...

Lumja – (e ndërpret) Fillove nga të tuat tani?

Vili – Jo të miat, nënë, të atyre...Mos nuk po them një të vërtetë?!

Lumja – Ka edhe të vërteta që nuk duhen thënë...

Vili – E vërteta është e vërtetë, nënoke...

Lumja – Sa po vonohet Vasfiu!...(Vili ngrihet, e përqafton dhe ulet përsëri.)Të të bëj një shurup me gjethe trëndafili?Apo do kafe?

Vili – Më mirë një shurup, se e ke bërë vetë..Kafen ruaje për miq se e kemi me racion...(Lumja nuk kthen përgjigje po kokëulur shkon drejtë bufesë, ndërsa Vili hedh një sy në dritare dhe pastaj ulet edhe një herë ne divan e nis të shfletojë librin...Pastaj shkruan.Lumja i sjell gotën e shurupit)

Lumja – Ç'po shkruan?Seminar?

Vili – Jo, është për Adën...Një material që i duhet nga frëngjishtja...

Lumja – Është material shumë i mirë...Mua më pëlqen shumë!

Vili – Ku e di ti ti?

Lumja – E kisha fjalën për Adën! Dhe bën shumë mirë që e ndihmon, se e kemi komshi...Vajzë arit!

Vili – Shumë e mirë...

Lumja – Dhe e bija e një babai të mirë, megjithese i rrangut të lartë, siç i quan ti...

Vili – E para është i rrangut të mesëm, e dyta, Muntazit i heq kapelen, edhe pse s'kam..

Lumja – Po atëherë ç'pret?

Vili – Ku e ke fjalën?

Lumja – Ajo qenka shumë e mirë, të atit i hiqte kapelën..

Vili – Kush ma var mua, moj nënë, shtresë e ultë hesapi!

Lumja - Kujt ia shet ato?Ajo vajzë ka rënë brënda me të dyja këmbët!

Vili – Ke sy të hollë, thua se je eksperte!

Lumja – S'është gjë e madhe ta kuptosh, si i shndrisin sytë, kur vjen, herë për një libër, herë për një fjalë në anglisht që s'e kupton, e herë të më pyesë mua, si e bëj musakanë...(Vili qesh)Dhe,shiko, ke motra vetë e mos u tall, se s'ke ku e gjen më të mirë...

Vili – (serioz)Ke të drejtë,s'kam ku ta gjej më të mirë!Por më vjen keq, se pa dashjen time ndoshta e kam futur në një shteg, që as më ka shkuar në mendje kurrë...

Lumja – Lëri teoritë, se për ato je i zoti!...

Vili – Jo, nënë, mos ushqe asnjë ilizion!..Ada është e përsosur, një shoqe e mirë dher vetëm kaq. E di, se ajo mund të ishte një grua ideale,që s'do ma prishte për asgjë, edhe kur të mos kisha të drejtë, po hë, pra, nuk më ngacmon...(tregon zemrën) Ç'ti them kësaj?

Vasfiu – (që hyn) Ule, more zërin, se dëgjohesh një orë larg!

Vili – Shoqja Lume mban përgjegjësi, se i ka hedhur fasules më tepër vaj se ç'duhet...Edhe ka dëmtuar ekonominë e familjes, edhe më ka shtuar mua kaloritë...

Lumja – Ç'i vë vesh këtij, more burrë, se je lodhur!..Pse u vonove?

Vasfiu – Kishte mbetur nje kamion i yni në në Shkozë e m'u desh të shkoja...

Lumja – S'gjetën xhenerik tjetër përveç teje?

Vili – Pse të lodheshin kot, kur ka shokë të bimdur, që nuk e njohin kundërshtimin...

Vasfiu – (ulet në tryezë) Ky është zanati im dhe do të përpiqem ta bëj sa më mirë, derisa ta dorëzoj...

Vili – Pastaj një ceremoni prekëse dhe..e gëzofsh pensionin!Dyzet e ca vjet punë vetmohuese, Vasfiu këtu, Vasfiu atje! Në borë, në shi, në ngricë, gjithmonë nën rrotat e makinës..Të lumshin duart dhe shëndet! Ndërsa në fund të pesëmbëdhjetëditëshit,

megjithëse rripi është shtërnguar tek vrima e fundit, numron kacidhet ndër xhepa, nëqoftëse të ka mbetur ndonjë...

Vasfiu – Do më lësh të ha një çapë bukë?

Vili – Të bëftë mirë, baba! Megjithëse thonë, se groshta është më e mirë, po të ketë pak mish...

Lumja – Vili!

Vili – Nuk thashë ndonjë gënjeshtër, moj nënë! Kam dëgjuar se qeni i shokut Nevzat ha...

Vasfiu –(nxehet) Do më lësh të qetë me gjithë shokun Nevzat, apo si e ke hallin? Po fajin e kam unë që s'të futa në punë! Të të kërciste bretku, e mos të binte ndërmend të flise kaq shumë...

Vili – Atëherë ndoshta do të më hapej goja më tepër...Me gojë të mbyllur asgjë nuk ndryshon në jetë...

Vasfiu – Unë jam i kënaqur nga jeta...

Vili – Unë e dua më të mirë...

Vasfiu – Syno dhe bëja hysmetin, por mos llap!

Vili – Llap se më dhimbsesh edhe ti...Prap ka për t'u shtuar edhe një thinjë tjetër në fund të muajit, kur ta sjellë rrogën të cunguar yte shoqe, që edhe sot u kthye në shtëpi për mungesë lënde të parë...(Vasfiu vështron Lumen.Ajo miraton me kokë.Vasfiu ngrihet).

Lumja – Po ti s'e mbarove pjatën!...

Vasfiu – Nuk më hahet!..Shko vishu!Petriti ka operuar të shoqen...

Lumja – Ua, kur kështu?

Vasfiu – Mbrëmë...(futen të dy në dhomë)

Errësim i pjeshshëm. Në dhomë hyn "Ai". E sheh Vilin të humbur në mendime dhe i afrohet dritares.

Ai – Kush është Petriti?

Vili – Një kushuri i largët i nënës...

Ai – Nuk priste koha deri nesër për t'i bërë vizitë?

Vili – Priste, po babai u zemërua dhe vendosi në çast...

Ai – Pati apo s'pati të drejtë?Tek e fundit, me kë u zemërua?

Vili – Nuk bëra mirë, që ia grrica plagën në mes të bukës...Ishte i lodhur...Edhe mbrëmë patëm një bisedë pak a shumë të tillë...Më saktë, flisja unë, kurse ai, edhe kur përpiquej të më kundërshtonte, më tepër donte të shuante dialogun, që i ndruhej, se sa të më kundërvihej...A thua se kishte frikë se mos vazhdimi i bisedës do ta nxirrte nga guacka e zakonit...Kisha përshtypjen, se shpirti i tij paqësor që trazuar nga një ndjenjë e re e porsalindur, apo e fjetur diku në shtresime, apo e gjallë po anemike, që kish nisur të ngrinte krye dhe të thërriste me zë të mekur...Kurse ai, për forcë zakoni, përpiquej ta shtypte këtë ndjenjë rrebele e çapraze që i prishi qetësinë standarte.

Ai – Përfundimi?

Vili – Nuk shpresoj ta kem aleat të fortë, por të paktën, nuk e kam as kundërshtar të fortë...

Ai – Pse, ti për ç'luftë përgatitesh?

Vili – Më shkrive gazit!Mos vallë mendon se do të përmbys botën? Jo, mor burrë, por ama, kushdo ka të drejtë të përpiquej ta bëjë atë më të mirë, apo jo?

Ai – Po dalin. Bën mirë t’i thuash një fjalë të ngrohtë. Unë po të pres, se dua ta vazhdoj bisedën...

Ai largohet diku në cep dhe rri me shpinë, në gjysëm terr. Vasfju dhe Lumja dalin. Vili bën dy hapa drej tyre.

Vili – Baba!

Vasfju nuk i kthen përgjigje po e sheh drejt në sy dhe del me kokë ulur. Lumja i vë Vilit dorën në sup dhe shkon pas të shoqit

Vili – Jam gati. Po pres...

Ai - Ke menduar ndonjëherë për Adën?

Vili – Asnjëherë...

Ai – Po për dikë tjetër?!

Vili – Mundet, por jo seriozisht...

Ai – As kohët e fundit?

Vili - Jo..

Ai – Nuk thua të vërtetën!

Vili – Qenke i lezetshëm! Po për cilën e ke fjalën, dreqi e mori?

Ai – Mos bëj dredha! Ti e di fare mirë...

Vili – Asgjë nuk di...

Ai – Kujt kërkon t’ia hedhësh? Po ç’pate atë natë pas mbrëmjes në shtëpinë e Klodit, që i bërë lëmsh çarçafët, duke u hedhur sa në një anë në tjetrën për të gjetur gjumin që kushedi nga kishte humbur?!

Vili – Ndoshta nga pija, ose...

Ai – Ose sepse ajo vajzë çapkëne, gjarpërushë e bukuroshe diçka gërvishti brënda teje...

Vili - Jo, atë natë e mora zët.. Më krijoi përshtypjen e një vajze tekanjoze, të gjithëpushtetëshme, siç e quajti Ylli, që nuk ishte mësuar t’i shkelej viza, që, falë kushteve të saj, mendonte se kishte të drejtë të merrte nepër këmbë cilindo... Prandaj dhe unë...

Ai – Prandaj dhe ti mblodhe tërë arsenalin tënd për t’i treguar se kishte konkurrentë në sedër dhe intelekt... Kështu?!

Vili – Një gjë e ligjeshme, kur je në mbrojtje të dinjitetit!

Ai – Të maskullit superior apo të njeriut?

Vili – Të dyja së bashku.. Të them të drejtën, atë çast ndjeva kënaqësi..

Ai – Po më pas?

Vili – Nuk më vrau ndërgjegja shumë, vetëm se më erdhi keq për të tjerët, që ua prisha atë mbrëmje të shumëpritur...

Ai – E zemë, se të besoj... Po atë ditë para Fakultetit, a nuk të tradhëtoi për pak zemra, kur e dallove nga larg?

Vili – Po, pata një çast... Po nuk u ndala...

Ai – Megjithatë, kur kaloi e mori kthesën, ti e gjete mënyrën për të kthyer kokën si rastësisht dhe të lëvriu dyshimi, se mos kishte ardhur për ty... Madje e ndoqe me sy, si një shoqëruar i denjë, se mos takonte ndonjë tjetër...

Vili – Një kuriozitet, asgjë më tepër..

Ai – Ashtu? Po dje ç’u bë shkak të humbje leksionin?

Vili – Ore, do të më lësh rehat, apo si e ke hallin?

Ai – Nuk të lë...

Vili – E pra as unë s’e di ç’po ndodh me mua!...

Ai – Mirë, mirë,ngrihu, se po bie zilja e derës!

Largohet. Vili ngrihet, shikon përreth i hutuar, por e sjell në vehte ziljsa që bie.Shkon ta hapë.Shtang për një çast, sepse në derë është Mirela dhe Klodi

Mirela – Mirëmbërëma,Vili!(*e përqafton.Vili e Klodi rrinë përballë njeri tjetrit pa folur.*)Nuk po na fton të hyjmë brënda?!

Vili – (*me gjysëm zëri*) Urdhëroni!...

Mirela – Nuk paske njeri?

Vili – Babai dhe nëna shkuan për një vizitë..Evi dhe Erisa, se ç’kanë një aktivitet në shkollë...

Mirela – E di, pse erdhëm?Kemi tërë pasditen që nuk zgjidhim dot një problemë...Me zor ia mbusha mendjen Klodit të vinim, po s’kishim nga t’ia mbanim!...Mos je i zënë?

Vili – Jo, jo..Ku e keni problemën?(*Mirela ia tregon. Vili i hedh një sy. Klodi vështron dhomën me të shpejtë. Se si Vili ngre kokën dhe e sheh, po merret përsëri me problemën*) Çfarë keni të paqartë?

Mirela – (*si e zënë në faj*)Po ja..nuk dimë...psh..(*Vili nis dhe u spjegon*) Ua, sa e lehtë paska qenë! (*Klodit*)A s’të thashë, se diçka fare e thjeshtë duhet të jetë!...Faleminderit,Vili!...A ka prap prej atij shurupit me trendafila?(*Vili matet të shkojë në dhomë, por Mirela e ndalon*)Prit, ty s’të vjen doresh për këtë punë!...(del)

Klodi – Kur e hape derën, megjithë mendimin që ke për vete, nuk ishte e vështirë të kuptohej, se u shtange...Pse?

Vili – Se edhe Greta Garbon mund ta prisja, ty jo!..

Klodi – Gjë e mirë, kur biseda nis me sinqeritet...

Vili – Megjithatë,edhe ti që ishe përgatitur për këtë surprizë, u shtange, pse?!

Klodi – Më infektove...

Vili – Ti pate edhe një befasim të dytë...

Klodi – Është e vërtetë! Nuk e kisha menduar thjeshtësinë (*tregon dhomën*) deri në këtë shkallë...

Vili – Që të ishit më e saktë, fjalën “ thjeshtësi” mund ta kishit quajtur ndryshe, megjithëse nuk jemi mësuar ta përdorim...Pra, siç e sheh, unë jam i varfër!...

Klodi – Të them të drejtën, në pak shtëpi kam hyrë,po...

Vili – Varet, ç’shtëpi kanë qenë...

Klodi – Te Mirela, përshembull...

Vili – Te Mirela përshembull, të ardhurat mujore, janë pothuajse dy herë më të mëdha se tek Vili, megjithëse Mirela ka vetëm një vëlla, kurse Vili një vëlla e dy motra...E nxjerr dot ndryshimin?

Klodi – Megjithatë, babi thotë, se të ardhurat mesatare për frymë...

Vili – (*e ndërpret*) Babi yt mund të thotë shumë gjëra, po ti në daç besoi atij, në daç këtyre dy divanave, që me sa shoh, ke frikë të ulesh, se nuk janë shumë të

butë...Megjithatë, unë jam krenar për to, se i kemi bërë “me forcat tona”, domethënë babai dhe unë...Ulu t’i provosh!

Klodi – Dua të rri në këmbë!...(*pauzë*) E di, se edhe sikur të ngelja në klasë, sot nuk do të vija këtu për të zgjidhur problemën...E merr me mend?!

Vili – Mundet...

Klodi – Po përse kam ardhur, atëherë?

Vili – S’është zakon të pyetet tjetri, kur të shkel në prag...

Klodi – Ta them unë! Sepse..ka tërë këto ditë, qysh pas asaj nate, që nuk jam e qetë...E kupton?

Vili – Jo..Ndoshta, të vret ndërgjegja për diçka...

Klodi – Mua?!Përse të më vrasë?

Vili – Mbase, nuk je pa ndonjë mëkat edhe ti, apo jo?

Klodi – (*përmbahet*) Kam ardhur të më kërkosh falje!

Vili - Ke ardhur në këmbë apo me autobus?

Klodi – Ç’është kjo pyetje?

Vili – Po, nëqoftëse kenë ardhur me autobus, gjysma e të keqes dhe unë do t’u ktheja paratë e urbanit...Po në rast se në këmbë, do të më vinte keq, që kenë marrë gjithë këtë rrugë vetëm për kaq...

Klodi – Pak të duket? Askush deri më sot nuk është tallur me mua, si ti atë mbrëmje...

Vili – Pse, ç’prisje, që pas sulmit tënd unë të duartrokisja dhe të të puthja këmbët? Duhet ta dish, nëqoftëse nuk e di, se jo të gjithë ata që ke përreth, mund të gjykojnë e të veprojnë sipas trillit tënd dhe se, edhe aty ku mungon luksi e mirëqenia e plotë, ka dinjitet...Këtë mos e harro, nëqoftëse nuk do të rrish edhe netë të tjera pa gjumë...

Klodi – (*gati sa s’qan*) Ti qenke...Po ku e gjen, xhanëm, gjithë këtë forcë? Po ti vërtetë nuk e kupton, se diçka më e madhe më ka bërë të shkel sedrën, ta zhubros si leckë e ta flak, vetëm e vetëm që të vi tek ti?... Vërtetë nuk e kupton?! Apo dëshiron të të bie në gjunjë?!Kënaqesh po ta bëj një gjë të tillë? Jam gati, po të ma kërkosh!...Vërtetë nuk e kupton, se aty dhe kur nuk e prisja kurrë, diçka që s’di ç’emër t’i vë, më ka trullosur, më ka dehur, sa nuk di se ç’bëj?!

Vili – Dehja kalon shpejt...Disa orë, kur është e lehtë, ose...

Klodi – Të lutem, tani që më detyrove të them atë, që as vetë perendisë nuk do t’ia thoja, mos u tall...Mos u tall, nëqoftëse je aq i fortë, sa ç’të kam përfytyruar gjithë këto netë! Të lutem!...

Vili – Nuk tallem, përpiqem të të sjell në vehte...

Klodi – Ke të drejtë, se nuk jam në vehte!...Tani nuk jam më ajo, që kam qenë; ajo e ëmbla, a dashura, e adhuruara...Tani jam një çupërlinë, një mendjehetë, një budallaçkë që vjen nga ana e anës e lutet, përgjërohet e zvarget si një rrugaçe...Ke të drejtë!..Ke të drejtë të mendosh e të thuash ç’të të dojë zemra! Më mposhte, mua të pamposhturën!...

Vili – Qetësohu, nuk më kuptove!...Nuk jam i lig të shfrytëzoj një dobësi...Edhe unë...Po kjo mos është vetëm një stuhi, që ngre përpjetë me gjamë pluhur, tymra, rrangulla, një stuhi që të gozhdon në vend e të mpin shikimin, sa të mos shohesh dy hapa larg?A s’është më mirë të pritet, sa të kalojë kjo stuhi, që të dallosh mirë, se mos ajo, që pak më parë të dukej një rrugë e drejtë, s’është gjë tjetër veçse një hendek i madh a një greminë?!

Klodi – Pra...ti paske menduar për mua! Po, po, ti ke menduar për mua!

Vili – Mendimi është abstrakt, konkret është realiteti...E pra, ky realitet çirret duke na thënë, se s’duhet injoruar nga zjarri i çastit, po duhet parë drejt në sy...

Klodi – (*e lumtur*) Konkret për mua je ti!...Të tjerat janë abstrakte... Abstrakte!...

Vili – Mos u ngut!...

Klodi – (*thërret*)Mirela, do të na qerasësh apo jo?!

Shuhen ngadalë dritat. Në paraskenë del “Ai”

Ai – Ç’qe kjo kthesë e papritur? E pabesueshme!Nje truk për të krijuar efekt! Një trill artistik!Nuk është e mundur kurrësesi një përmbysje e tillë! Jo, kjo është një lajthitje! I dashur, mik,që mund të gjykosh kështu, mos u ngut! Jo çdo gjë mund të rrjedhë në shpirtin e njeriut ashtu siç do ti,

sipas një logjike matematikore, dy plus dy bëjnë katër! Po a nuk të ka rënë rasti të shohësh një fortunë të vërtetë me erë e rrebesh, me qiell të nxirë, re të çmenduara e vetëtima, që të kallin frikën? Me siguri, i detyruar të dalësh në një mot të tillë, ke turfulluar me vehte, mbase edhe ke sharë, pa ditur ke shan, kur befas, si me magji, gjithçka bie paq...Përrjashta të pret një qiell i pastër dhe një diell i këndshëm, që disi e përqesh fëtyrën tënde të habitur...

Ç’na ngatërron kot, ti mund të rezishtosh...Nuk je dakord, qe njeriu është pjellë e natyrës? Po, atëherë, me që je,si thua, a nuk mund t’i ngjajë pjella nënës së vet?! Në mos në gjithçka, të paktën, në këto ndërlikime...

Nejse, duam apo s’duam ne, për ata të dy nisi ajo, që dikush poetikisht e quajti “Stina e dashurisë” Kush e ka provuar, s’ka nevojë për koment, kush jo, është për të ardhur keq, se nuk mund ta përfëtyrojë kurrë, sado i aftë qoftë ai që e përshkruan...

Po mirë, e gjatë apo e shkurtër është kjo stinë në jetën e njeriut? Varet nga rrethanat, domethënë nga rrebeshet...

dritat

Tabloja e tretë

Shtëpia e Klodit e sistemuar si për një ditë të zakonëshme. Salloni luksoz është në gjysëm errësirë. Dy porta ballore dhe shkallët që ngjiten në kat të dytë. Në të djathtë është veranda e mbushur me lule. Një tavolinë rrumbullake xunkthi me tre karrige të gjëra me mbështetëse po prej xunkthi. Në njerën është ulur Leta, që vështron në kopësht. Në krahun e saj të djathtë është Sandri, një burrë i gjatë, që nuk i ka mbushur dyzetat, i pashëm dhe i veshur me shije. Ata të dy pijnë në heshtje çajin e servirur në filxhanë të mëdhenj të një servisi të kushtueshëm. Aty pranë, në këmbë, veshur me një robdëshambrë ngjyrë vishnjë të mbyllur, me një telefon të lëvizshëm në dorë, flet shoku Rudi. Është muzg pranverë...

Rudi – Kuptova...Ashtu mendoj edhe unë...Mirëupafshim, shoku Nuri! Faleminderit!(*Letës*) Të fala nga shoku Nuri!...(Ajo vë buzën në gaz. Rudi i bie numrit tjetër.) Alo, Mensur ti je? Dëgjo, nesër në mëngjes, eja më merr në orëmb pesë...(Instinktivisht Sandri dhe Leta ngrejnë kokat dhe shikojnë njeri tjetrin drejt në sy) Po,po, kemi rrugë të gjatë!...I thuaj Lules, të bëjë si të bëjë nja dy ditë pa ty!...Po,po e dëgjova si qeshi...Natën e mirë!

(*ul dorezën dhe ze vend në karrigen bosh. Merr në dorë filxhanin e çajit*) Qenka ftohur fare! (*thërret*) Nasta! (*Ajo del me të shpejtë nga njera prej dyerve ballore duke ecur me të shpejtë. Leta dhe Sandri sikur përpijnë njeri tjetrin me sy.*) Ishe zënë? Më fal, po m'u ftoh çaji...(Ajo thuatse vrapon. Rudi zë vend pranë tavolinës)

Leta – Ç'qe ky shërbim i papritur?!

Rudi – Në Vlorë, me shokun Nuri! Ka dalë një problem...

Leta – (*si me keqardhje*) Edhe kjo e shtunë na u dogj...

Rudi – Detyra, grua e dashur!..

Leta – S'të zunë këmbët dhe, o Rudi!...Sa në Shkodër, në Elbasan, Kukës, Rrëshen!...

Rudi – (*qesh*)Pse nuk përmend edhe sa në Paris, Gjenevë, Stokholm!.. Apo këto nuk i quan shërbime ti?! (*kujtohet*) A, Sandër, se më doli nga mendja. Ato tre mbledhjet e parashikuara për nesër, të shtyhen! Caktoje vetë një datë, ku të gjesh një dritare, po para të enjtes, ama! (*hyn Nasta që sjell një tjetër filxhan me çaj*) Të lumshiu duart, Nasta dhe më fal se të shqetsova!... (*ajo del*)

Sandri – E dini, shoku Rudi, se megjithëse kam ardhur kaq herë këtu tek ju, deri më sot nuk e di, se si flet kjo kushurira juaj...

Rudi – Eh, Nasta e shkretë! Shumë trauma ka patur në jetë, që sigurisht kanë lënë gjurmë...Katërmbëdhjetë vjeçe i humbi të dy prindërit e vëllain në një aksident e mbeti kuk vetëm. U kujdesën për të ca komshinj, se ne jemi fis i vogël, bile dhe e martuan me një hidraulik. Por ai pinte shumë dhe një natë e goditi...Ajo iku nga shtëpia e s'u kthye më...Dhe nuk u martua më, edhe pse ishte vetëm njëzet e tre vjeçe...Unë isha me studime jashtë... Pastaj puna e re, qarkullimet, martesat me Letën, lindja e Klodit, pastaj detyrat e rëndësishme që më ngarkuan, të gjitha këto më kishin shkëputur nga qyteti i lindjes e nga njerëzit e mi...Rastësisht mësova para një viti, se kisha një kushurirë në Korçë...E kisha

njohur fëmijë,tani po e shihja grua të thyer nga moshja e hallet.Më erdhi keq për të dhe e mora të jetonte me ne...Kjo është Nasta!...

Sandri – Ju kam zili bujarinë dhe shpirtin e madh, shoku Rudi!

Rudi – Kushdo do të vepronte kështu, apo jo, Lerta?

Leta – (*me gjysëm zëri*) Po, po, natyrisht...

Sandri – Mua të më falni!Më duhet të largohem! (*përshëndetet dhe del*)

Rudi – Ngazllehem megjithëmend, kur shoh se si po ecën ky djalë! Më pëlqeu sapo e pashë në Fier...E transferova në Tiranë dhe e mora pranë vetes.Kuadër që e gatova pak nga pak, me duart e mija...Dhe tani shkoj i qetë me shërbim, se kush të më zevendësojë...

Leta – Megjithatë, deri më sot, s’ e ke marrë me vete në shërbime jashtë kufinjve...

Rudi – Ka kohë...Nuk i duhen afruar tjetrit të gjitha të mirat njëherësh, se pastaj humbet interesi..*(befas)* E di, Leta, se je më je rinuar goxha kohët e fundit? E kam me gjithë mend! Se ç’ të ka rënë një nur!..

Leta – Është merita yte, burrë i dashur!

Rudi – Jo, është edhe konstrukti, tiparet..*(pauzë muzikore)* Njëzet vjet!..

Leta – Në korrik plot njëzet e një...Isha vetëm shtatëmbëdhjetëvjeçe!

Rudi – Unë tridhjetë e një, pulëbardha ime!

Leta – Kështu më quajte atëherë në breg të detit, po kjo i përket së kaluarës së largët...Se pastaj menjëherë u fejuam, se pa u mbushur viti hyri ne mes Klodi, se nisen telashet, emrimet, riemrimet, raportet, studimet, shërbimet...Të gjitha këto ishin shumë larg pulëbardhave...*(Hyn Nasta për të marrë filxhanat)*

Rudi – Ulu Nastë, rri pak!...

Nasta – Nuk kam kohë (*del*)

Leta – Je shumë i vemendshëm ndaj saj!...Edhe nga Parisi nuk harrove t’i sjellësh një suvenir...

Rudi – E ç’ është një fustan për Nastën, përpara atyre që të solla ty e Klodit? Nuk e pe si i shndritën sytë?

Leta – Aq, sa as edhe të falenderoi!

Rudi – Duhet pyetur shpirti i saj...

Leta – Ti merre si të duash, po mua më tërbon me heshtjen e saj...Vjen e ikën si hije..E kishim mangut një fantazëm nepër shtëpi!...

Rudi – E cila, duke të çliruar nga të gjitha punët e shtëpisë, të ka krijuar mundësinë ta shfrytëzosh kohën si të të teket...Këtë mos e harro kurrë, se atëherë nuk do të të duket si fantazëm...

Leta – (*ngrihet*) Po shkoj në dhomë...Më duhet të përgatitem për një mbledhje dekanati...

Del.Rudi e ndjek me sy një çast, pastaj ulet në karrigen e tij dhe vështron nga kopshti. Hyn Nasta.

Rudi – Eja, Nastë, ulu!*(ajo ulet dhe nuk ia ndan sytë.)* A u lodhe?

Nasta – Jo...

Rudi – Të ka marrë malli për Korçën? Nesër nisem për në Vlorë, po kur të kthehem, mund të shkojmë ndonjë ditë..

Nasta – Nuk dua...(pauzë) Do të rrish shumë në Vlorë?
Rudi – Nja dy ditë, pse pyet?
Nasta – Kot...(e vështron drejt)
Rudi – Pse më shikon kështu?Ke diçka për të më thënë?
Nasta –
Rudi – Fol, mos ke ndrojtje!
Nasta – Unë...po të thuash ti...në qoftëse u jam rënduar...mund të largohem që
sonte...
Rudi – Ç’thua kështu! Ti je në shtëpinë tënde...Mos të ka thënë kush gjë?
Nasta – Jo, askush...po unë, ashtu kot, mendova...
Rudi – Gabove, Nastë, gabove! Ti je njeriu im...
Nasta – E di, je shumë i mirë!...Po unë..nuk mërzitem po të...
Rudi – As mos të të shkojë ndër mend...Ne të gjithë të duam, unë, Leta, Klodi..
Nasta – Edhe unë..Klodi është shumë e mirë...e dua si çupën time...Ajo të ngjason
ty...
Rudi – Edhe Letës..
Nasta – Jo, më shumë ty...Unë nuk ia dua të keqen Klodit...Dua ta shoh mbi tërë
botën...
Rudi – As që e vë në dyshim...
Nasta – Dhe Klodi nuk duhet të mendojë keq për mua...
Rudi – Mos të ka thënë gjë?
Nasta – Klodi? Jo...është shumë e mirë... e re ..e bukur...
Rudi – Diçka më fsheh, më duket..
Nasta – Ty nuk të fsheh asgjë...Je shumë i mirë...prandaj erdha...se nuk të fsheh
asgjë...
Rudi – Si është puna, Nastë?
Nasta – Po Klodi s’duhet të mendojë keq për mua...E dua si çupën
time...Klodi..ka nisur me një djalë...
Rudi – Je në vehte? Cili është, Ylli?
Nasta – Jo, nuk është doktori...Është një tjetër...Ishte edhe në ditëlindjen e
Klodit...Tek një tavolinë atje... Po Klodi është vajzë shumë e mirë...
Rudi – Kush të tha?
Nasta – Askush s’më tha...E pashë vetë...Klodi s’duhet të më shajë..Për të mirën e
saj e kam...
Rudi – Ku i ke parë?
Nasta – Ja, aty në sallon...Sot në mëngjez..
Rudi – Noshta është shok i saj...Klodi ka shumë shokë...
Nasta – Nuk ishte shok...Shoku nuk të...
Rudi – Çfarë?
Nasta – Më vjen zor prej teje...
Rudi – Po Klodi?
Nasta – Ajo iu hodh e para në qafë...
Rudi – Ashtu?! Po pse nuk më the më parë?
Nasta – Tani të gjeta vetëm...Unë doja ta thoshja vetëm ty...(Rudi bie në mendime)
Të mërzita? Më fal!..Po ty nuk të fsheh asgjë...

Ngrihet dhe largohet me ndrojtje drejt sallonit, i cili është në gjysëm errësirë. Tek shkallët e pret "Ai"

Ai – E preve Klodin në besë!...Ajo të do shumë...

Nasta – Unë për të e kisha...Rudit s'mund t'i fsheh asgjë...

Ai – Asgjë?

Nasta – Asgjë...

Ai – Vërtetë?

Nasta – Nuk mund të them diçka që nuk e besoj...

Ai – Çfarë nuk beson?

Nasta – Atë që tha ai djali...Rudi më do shumë...

Ai – Pse, çfarë tha ai djali?

Nasta – S'dua ta them...Ai shpif...Rudi më ka si motër...Edhe unë e kam si vëlla...Gjithëçka që bëj, e bëj me dëshirë...Nuk di si t'ia shpërblej... Më futi në familje...Më solli edhe fustan nga Parisi...Ç'do natë e vesh në dhomën time...Është shumë i bukur, po nuk dua ta vesh përjashta...Vetëm në dhomë...Atje kenaqem më shumë...

Ai – Ti the se ai djali shpifi...

Nasta – Shpifi...E dëgjova vetë që shpifi...Po Klodin nuk e dëgjova se çfarë tha, se m'u errën sytë, kur e dëgjova atë djalin ç'tha ashtu për Rudin.. dhe ika...

Lokalizim dritash në një cep të sallonit. Vili sheh një tablo në mur.Klodi i shkon nga pa dhe i hidhet në qafë. Nasta që po zbriste nga shkallët i sheh dhe ndalon. Ata të dy puthen.Pastaj Klodi qesh.Duke u rrotulluar e lumtur dallon Nastën, që kërkon të ngjitet shkallët përsëri.

Klodi – Ej,Nasta!(ajo ndalon)Mos ik! Vili,kjo është Nasta!(Nasta nuk reagon.Vili e përshëndet)Na zure me presh në duar, Nasta!Ti je dëshmitarja e parë..Na pagëzo, Nastë dhe ruaje këtë sekret edhe për pak kohë...(Nasta zbret shkallët ngadalë dhe futet në njëren nga dhomat)

Vili – Shumë lehtë e kalove këtë çast...

Klodi – Ta mohoja?Nasta sytë në vend i ka?

Vili – Po gojë nuk ka?!

Klodi – Rrallë flet, po është shpirtmirë dhe më do shumë..Dhe s'pushon tërë ditën..Lan, pastron, gatuan,qep, thur, ujit...Të gjitha punët ajo i bën...

Vili – Kurse ti dhe mamaja rrini...Babai yt më duket, se i ka rënë lapsit hollë...

Klodi – Ç'ke me babain?

Vili – Se ai s'kishte ku të gjente një shërbëtore që të kushtonte kaq lirë, sa kjo e ngratë, që shpërblehet vetëm me pjatën e gjellës...

Klodi – Vili!

Vili – Ma ke njohur tipin,që s'mund të mbajë brënda asgjë...

Klodi – Je i pamëshirshëm!...

Vili – Jam i drejtë...

Shuhen dritat.Kur ndezen përsëri Nasta është përballë "Atij"

Nasta – M’u errën sytë nga ajo shpifje dhe nuk dëgjova më nga prapa derës...Po kjo nuk është e ertetë..Mua Rudi më do...Edhe sikur të ishte e vërtetë, unë ç’humbas? Punët i bëj me qejf, se kaloj ditën dhe mërzinë...Me njerëz rreth e rrotull jam, e jo kuk vetëm...

Ai – Po Leta?

Nasta – Kush?

Ai – Leta..

Nasta – Ajo është ndryshe...

Ai – Si ndryshe?

Nasta – Ajo do vetëm veten e saj...Edhe Klodin e do..po më shumë veten..

Ai – Po Rudin?

Nasta – Ku vajti dhe e gjeti ai këtë grua?!

Ai – Mos flet nga inati, se nuk të do?

Nasta – E ç’rëndësi ka, në më do apo s’më do mua...Për të jam e huaj.. Ajo të shohë veten, se nuk është çupërlinë...

Ai – Për se e ke fjalën?

Nasta – Ou, ti t’i nxirrke llafet me grep! Ç’do që gërmon kaq shumë? Jam betuar që për këtë të mos flas kurrë...Aq më tepër që e kam vetëm dyshim...

Ai – Ti mendon se Sandri...

Nasta – Qenke interesant ti! Unë nuk përmenda asnjë emër...

Ai – Mos të lindi dyshimi një pasdreke, kur Rudi ishte në Francë?

Nasta – Kur i ditke të gjitha ç’më pyet?

Ai – Ti kishe shkuar për të bërë pazarin..Ishe larguar plot dhe ndjeheshe e lodhur ca...

Nasta – Po ashtu ka qenë...Para se të hyja u ndala të pushoja pak në oborr...Dëgjova që ajo po fliste me Sandrin në telefon...Dy herë i përmendi emrin...Mua nuk më bëri përshtypje, se kohet e fundit ai është bërë si i shtëpisë, po kur unë hyra brenda e ajo më pa, e thirri Vjollca...Po të mos bëhej Sandri Vjollcë, nuk do të dyshoja, po pse të bëhej Vjollcë, kur ishte Sandër?

Rritet ndriçimi. "Ai" nuk është më aty. Nasta sheh një herë përreth dhe futet e menduar në një rën nga dhomat.Ndriçim i plotë. Nga veranda del Rudi.

Rudi – (therret)Leta!

Leta – (që del pas pak)Më thirre?

Rudi – Po.Dua të them një të papritur...Klodi ka nisur me një djalë...

Leta – (e interesuar) Je në vehte? Kush ta tha?

Rudi – Më thanë...

Leta – Mos është Ylli? Diçka kam nuhatur...

Rudi – Jo, një tjetër...

Leta – E sigurtë?

Rudi – Po.

Leta – Kush është ai?

Rudi – Nuk e di...Shpresoj të na e thotë ajo vetë...

Leta – Sikur ka nisur të dalë ca më shpesh kohët e fundit...

Rudi – Me qetësi, pa e vrarë...Mbase është djalë, që ia vlen.
Leta - Është vetëm tetëmbëdhjetë vjeçe...
Rudi – Ti ke qenë shtambëdhjetë, kur më dashurove...Apo jo, pulëbardhë?
Leta – Po..po..vërtetë...Më duket se po vjen!Po dëgjoj hapat...

Shkojnë në verandë.Nasta del nga porta, ku hyri pak më parë. Njëkohësisht me të futet në sallon edhe Klodi, që është në qejf.

Klodi – Ou, po pse i ka vërenjtur vetullat Nasta sonte?(*e përqafton*)
Nasta – (*largohet*) Mos më puth!..
Klodi – Pse, ç’e ka zemëruar Nastën tonë? Aha, Nasta i mban mëri Klodit! E di unë pse...
Nasta – Asgjë nuk di...
Klodi – Po ç’ke atëherë, moj Nastë e mirë?
Nasta – Nasta nuk është e mirë, është e keqe!...
Klodi – Nasta është shumë e mirë...Ajo ia ruan Klodit sekretin!..
Nasta – Jo, nuk e ruaj...
Klodi – Ke vendosur t’ i thuash babait?
Nasta – I kam thënë, prandaj mos më puth!...Nasta është e keqe...
Klodi – Ashtu?! Domethënë ajo që ishte sekret, nuk është më sekret..
Nasta – Nuk është...
Klodi – E megjithatë Nasta nuk është e keqe, se nuk ka treguar diçka të keqe...Ku është babai?(*Nasta bën me kokë nga veranda. Klodi shkon atje*) Mirëmbërëma!(*i përqafton*)
Leta – Qenke në humor sot!
Klodi – Pse të mos jem? Sapo u ndava ne një njeri që e dua shumë...
Leta – Kush qenka kjo?
Klodi – Nuk është “kjo”mama,është “ky”!
Leta – Dhe e thua kaq qetësisht, sikur tregon një përrallë?
Klodi – Sepse u përgatita që jashtë, mama...Kisha vendosur t’jua thoja.. Apo e dini? Po të jetë kështu, më jepni vendimin..
Leta – Asgjë nuk dimë..
Klodi – Megjithëse ju e dini, po jua thjem me gojën time: Unë e dua Vilin!...
Leta – Ç’do të thotë “Vili”?

Klodi – Një emër i bukur i gjinisë mashkullore, që e mban një subjekt i po kësaj gjinie, nga i cili sapo u ndava...

Leta – Ti flet sikur luan, apo kujton, se na i merr mentë me këto lojra fjalësh?
Klodi – E si mund të më jepni mend, po t’i keni të marra? Jo, mama, ju dua me mend të pamarra...Kurse mënyra se si flas, ka të bëjë me stilin e autorit..Ju shihni përmbajtjen!...Pyetjet tuaja i konsumove, mama, lëri rradhë babait!...
Rudi – Je e bindur, se nuk është një trill i çastit apo i moshës?
Klodi – Nuk është trill,baba...Ne kemi tre muaj që duhemi...Që në ditëlindjen time..Ajo u bë shkas...

Rudi – Po kush është ky djalë?
Klodi – Vili Rumina! Djali i xhaxhait i Mirelës...

Leta – Aaa,bravo Mirela!
 Klodi – Ajo nuk ka lidhje fare, mama!Kurse Vili ka prindërit, një vëlla e dy motra shumë simpatike...
 Leta – Të rrofshin!
 Klodi – Të faleminderit, mama!
 Rudi – Ç’punë i bëjnë prindërit?
 Klodi – I ati xhenerik, e ëma tezgjahiste!...
 Leta – (e befasuar) Çfarë janë?
 Klodi – Njerëz të ndershëm, mama...
 Leta – Moj, ti paske lajthitur fare!..
 Rudi – I ke menduar mirë të gjitha?
 Klodi – Po..
 Rudi – Mirë...Tani për tani s’mund të themi asgjë...Natyrisht që s’duam të të thyejmë zemrën, po s’bëhet me njëherë kjo punë...Duhet të interesohemi me kë lidhemi, apo ko?
 Leta – Ç’lidhje më zë në gojë, O Rudi, pashë kokën tënde!Preja shkurt!
 Rudi – Jo, Leta, vajzën e kemi të mençur...Shiko, bijë...Do të interesohemi...
 (Klodi del)
 Leta – Ç’ishte ky qëndrim?
 Rudi – Kështu duhet!...
 Leta – Kjo lidhje duhet prishur një sahat e më parë..Dëgjove, duhet prishur!..
 (Rudi merr telefonin dhe i bie numrit)
 Rudi – Alo,Sandër, brenda këtyre dy ditëve që s’jam, dua të dhëna të hollësishme,për studentin e vitit të katërt të injinierise Vili Rumina!
 dritat

Tabloja e katërt

I njejtë dekor. Është pasdreke. Klodi po zbret nga shkallët. Nxiton. Leta del nga dhoma.

Leta – Po del?
 Klodi – Po dal..
 Leta – Mësimet i bëre?
 Klodi – Kuptohet...
 Leta – Kaq shpejt?
 Klodi – Pse shpejt? Nesër kam vetëm dy orë...
 Leta – Ditë të tjera ke studiuar më shumë...
 Klodi – Varet nga ditët..Për ditën e nesërme, për shëmbull, më mjaftonin dy orë studim...
 Leta – Ku kështë me kaq ngut? Dua të flas me ty..
 Klodi – Kemi folur sa jemi shqepur ditë për ditë..E bëjmë pushim sot? Apo të ka ngelur gjë pa më thënë...(shesh orën) Mirë, kam pak kohë...
 Leta – Dua të të flas si nënë dhe si shoqe më e madhe...
 Klodi – Pranoj...

Leta – Mos e merr me të tallur! Ti vazhdon të flasësh si për një lojë... Po nuk luhet kështu me jetën, se të ndëshkon...

Klodi – Nëqoftese jeta do të më japë atë kënaqësi, që po më jep kjo lojë, pse duhet të trembemi i t'i vemë një emër tjetër? Loja, në përgjithësi të argëton, të shlodh, të mbush me gëzim...

Leta – Në përgjithësi...Gjithmonë varret nga partnerët...

Klodi – Partnerët e mi janë të denjë...

Leta – Ashtu thua?

Klodi – Sepse ashtu mendoj...

Leta – Kurse unë, meqë mendoj ndryshe, them ndryshe...Partnerët. që ke zgjedhur, shumë shpejt, sa të kalojë kjo puhi trulllosëse, do të shfaqen ashtu siç janë të vërtetë, domethënë jo të jo denjë si partnerë...

Klodi – Gabohesh, mama...

Leta – Nuk do të më thuash kështu, pas disa vjetësh...Kur, pasi ke braktisur gjithë këto të mira që të rrethojnë, qysh se hap sytë e derisa të mbërthen gjumi i thellë i natës, do të gdhiesh e ngrysesh me një shqetësim brejtës, se këpucët e parashikuara për djalën a vajzën e vogël, nuk mund të blihen...

Klodi – Pse, unë dhe Vili do të kemi rroga të mira...

Leta – Që gjithësesi do të të privojnë nga shumë gjëra që je mësuat mos të të mungojnë...Pastaj, prit, se gjërat duhen marrë me rradhë...Derisa ti të kesh mbaruar shkollën e lartë, duhen edhe pesë vjet të tjera...E di se ç' do të thotë pesë vjet? Do të thotë që fare mirë, një ditë të bukur të mos ulesh në bangat e saj, sepse...

Klodi – (*e kupton*) Kanë duruar të tjerët më shumë...

Leta – Ata kanë qenë të tjerë...Megjithatë, e zemë, se edhe zi futesh tek ata të tjerët...Por mos harro, se ëndrrave të tua u ke rënë shkelm njëherë e mirë...Babai yt sa po bëhej gati të të rezervonte një vend në Sorbonë, prej nga, pasi ke shijuar tërë bukuritë e Parisit, pasi ke marrë atë kulturë, që jo gjithëkujt i bie për hise ta shijojë, mund të ktheheshe tjetërkush...

Klodi – Po kjo s' do të më pengojë të shkoj atje...

Leta – Je aq e fortë sa të rezistosh kaq kohë?!

Klodi – Jo, ke te drejtë...Nuk mund të rri një çast pa Vilin!..

Leta – E sheh? Pra, kjo ishte vetëm sakrifica e parë...Vazhdojmë më tutje.Cilën nga dy dhomat aktuale të shtëpisë së familjes Rumina ke menduar të kesh si dhomë gjumi?

Klodi – As që kam menduar...

Leta – Po duhet të mendosh...E di, pse pyes? Sepse sipas një llogarie të thjeshtë, në një rën do të flejnë pleqtë, në tjetrën dy gjimnazistet simpatike, që s' dihet kur u del fati, në kuzhinë ushtari, që lirohet pas një viti...Po ti, ku do të flesh pasi të kthehesh nga muaji i mjalitit?!...Apo ai bandilli yt ia ka vënë syrin kësaj çatie!...S'ke faj, qenka i mençur...Ta ka hedhur grepin me largpamësi...Ne mbase edhe kemi ëndërruar, që një ditë kjo shtëpi të zhurmonte nga zhurmat e kalamajve të vajzës sonë të vetme, por ama, me një njeri, në mos i rrangut tonë, aty afër, që të mos vinte nga hiçi, se i urituri, kur ulet në një tavolinë të mbushur plot, nga nguti që t'i provojë të gjitha, ka rrezik të mbytet...

Klodi – Ai nuk ka asnjë iluzion për të ardhur këtu...

Leta – Ndoshta, po kjo dëshirë mund të lindë më vonë dhe unë nuk kam aq nge e durim, sa të pres e të përcjell, gjithë zanatet profesionale të fisit të tij të madh...

Klodi – Po flet me përbuzje..

Leta – Prit, mos u ngut! Do të shohim ca më vonë, se si do të flasësh ti...Por ka edhe një rrugë të mesme, që babi të interesohet dhe e gëzofshi shtëpinë e re! Por me gjithë ndihmën tonë, ajo do të ketë aq shumë mungesa, sa ty shumë shpejt do të ulet entuziasmi e romantizmi...

Klodi – Ne asgjë nuk kemi vendosur tani për tani..Vili është më i madhi i fëmijëve dhe ka detyrime...

Leta – Atëherë?

Klodi – (*disi e zënë ngusht*) Pse duhem të vrasim mendjën kaq shumë tani, mama?

Leta – Se duhet vrarë, moj budallaçkë! Duhet vrarë që të mos kesh kthesa të papritura e të pakëndëshme..Ti e ke lënë mënjane trurin, si të kesh pirë hashash dhe i je dorëzuar plotësisht kësaj(*tregon zemrën*).Po mos harro se ajo zemra e një tetëmbëdhjetëvjeçareje

Klodi – Ti ishe më e re, mama, kur...

Leta – Jo gjithkush mund të ketë fatin tim...Mua s'më kishte thënë njeri, se më pret Parisi, nuk isha e shkëlqyer në mësim si ti, nuk i kisha këto kushte që ke ti tani...Edhe unë, kushedi ku do të rropatesha, sikur mos të ishte ajo kthesë lumturuese në jetën e babait tënd...Por një fat i tillë, përsëritet tepër rrallë...E përgjithëshmja është ndryshe...

Klodi – Edhe unë futem tek të veçantat, mama, për derisa kam një thesar si Vili...Po ju kam edhe ju, që mund të më ndihmoni nesër...

Leta – Nesër? Po ku dihet se ç'mund të ndodhë nesër?!

Klodi – Atëherë, vërtetë, pse merremi kaq shumë me të nesërmen? Më mirë po merrem me atë që kam sot e po më pret tani...Mirëpafshim mama! (*e puth dhe vrapon. Në derë gati sa s'përplaset me të atin*) Baba!

Rudi – Kujdes, moj bijë!...Për pak më shtype!(ajo i hidhet në qafë) Ku nxiton kështu?

Klodi – Po dal..

Rudi – Mirë, dil...Flasim në darkë...

Klodi – Nëqoftese është ajo, që unë pres kaq ditë, mund të shkoj edhe pak më vonë...

Rudi – Po, meqë ke dhënë fjalën...Ne kemi kohë...bisedojmë, kur të kthehesh...

Klodi – Unë dua tani, baba!

Rudi – Mirë atëherë...(*i vë dorën mbi flokë*) Dhjetë ditë më parë ne mësuam një lajm,që na befasoi, jo se nuk do të ndodhte një ditë, por na u duk se erdhi ca si shpejt dhe kur nuk e prisnim...Shkaku i vetëm i ngurrimit tonë ishte moshja dhe e ardhmja jote, apo jo Leta?(*ajo tund kokën*) Pse ta mohoj? Edhe u mpiva, edhe u mallëngjeva, sepse po më trokiste në portë diçka, që unë e kisha menduar tepër të largët dhe, pse të gënjej, u bëra xheloz...Po, po, xheloz, sepse dashurisë tënde tash e tutje do t'i shtohet edhe një destinacion tjetër, që mbase, ku i dihet, mund të thithë porcionin më të madh...

Klodi – O, jo,baba!

Rudi – Ashtu është, bija ime, ligj i natyrës...Patëm përshtypje, se rasti në fjalë nuk të përshtatej ty...Është kjo arsyeja, që disa herë unë u përpoqa të të ndroja mendjen, të të bindja në të kundërtën e asaj që mendoje ti...Po kështu edhe jot ëmë...Konkluzioni? Ti

nuk i merr për bazë argumentat e prindërve të tu, ngulmon e vendosur në mbrojtjen tënde, që si armë të vetme ka dashurinë e pastër...Kështu?

Klodi – Po, babi, duhemi shumë...

Rudi – Atëherë, përballë një rezistence të tillë, mua, si babai yt nuk më mbetet gjë tjetër, veçse të tërhiqem nga lufta, natyrisht me zemër të thyer..Por para se të jap fjalën time, është e natyrshme, që unë të interesohem për dorën që do të mbajë vajzën time të vetme, gjakun tim...

Klodi – Baba!...

Rudi – Nëqoftëse ajo dorë nuk do të ishte krejtësisht e pastër, përgjigja do të ishte kategorike: jo!

Klodi – (në ankth) Baba!

Rudi – Pastaj do ta kishe ti të drejtën të vendosje, por mua dhe jot ëmë do të na humbisje përjetë...

Klodi – Baba!

Rudi – Po ti, a mund të na braktisje aq lehtësisht në një rast të tillë? Unë mendoj, se jo...E them këtë, sepse, kam përshtypjen, se të njoh mirë...

Klodi – Baba, po Vili...

Rudi – (e ndërpret) Tani le të vijmë tek Vili. Për të dhe familjen e tij ka vetëm fjalë të mira...(Klodi merr frymë lirshëm) Student i shkëlqyer, familje e thjeshtë, por e ndershme...Përpara një karakteristike të tillë, unë dorëzohem...

Klodi – (e emocionuar) Baba!(e përqafton)

Leta – Rudi, je në vete?

Rudi – Nuk mund t’ia prishim zemrën vajzës, grua e dashur, pa patur arsye të fortë...Ata të dy duhen, të tjerat rregullohen...

Leta – (ka filluar të nxehet) Rudi!

Rudi – Qetësohu, e dashur, gjithëçka do të vijë mbarë...Parimorë dhe demokratë nuk duhet të jemi veç për të tjerët...Duhet filluar nga vëhjtja...

Leta – Të rrofshin parimet!

Rudi – (e përqafton të bijën) Për mua që nesër mund të shpallni fejesën!...

Leta – Për mua kjo nuk do të bëhet kurrë!

Rudi – Duhet, Leta, duhet!..Bile, thuaji Nastës të na përgatisë një darkë të mirë..(Klodi) Po të dojë Vili, mund të vijë qysh sonte...

Leta – Hajeni pa mua atë darkë!...(hyn me të shpejtë në dhomën e saj)

Rudi – Mos e gjyko nënën tënde!...Shpejt edhe atë do ta kemi në krahun tonë...Tani mund të shkosh!

Rudi ngjitet lart nëpër shkallë.Klodi matet të dalë, por në derë shfaqet Mirela që mezi merr frymë nga të vrapuarit.Është e alarmuar

Klodi – Mirela, ç’ke kështu? (Ajo përmes lotësh sheh njëherë përreth e qan me dënësë) Fol, moj, ç’ka ngjarë?

Mirela – Vili!

Klodi – Çfarë ka Vili?

Mirela – E kanë arrestuar...

Klodi – Çfarë?! Mos u çmende? Ti talleh, Mirela!...Nuk është e vërtetë!...

Mirela – Është...Para dy orësh...Në shtëpi...Xhaxhai erdhi me vrap tek ne...Ishte bërë si i lojtur..Bashkë me babin u nisën menjëherë nga hetuesia...

Klodi – Mirela, thuaj të lutem që jam në ëndërr...Të lutem..Të lutem! (*e prek*) Pra qenka e vërtetë! O, zot, po luaj mendsh!Unë sa po bëhesha gati t'u sillja sihariqin, kur befasi ti më sjell mandatën...Si është e mundur?! Si është e mundur kaq lehtësisht, kaq pa mëshirë të rrokulliset fati im e të thërmohet si një copë qelq? Kjo është e tmerrshme! Dëgjon Mirela, kjo është absurde, e pamundur, e pabesueshme! Ti gënjen!Gënjen! Thuaj që gënjen! Thuaj, pashë vitet që kaluam bashkë, pashë gëzimin tim, që zgjati veç një grimë, thuaj që s'është e vërtetë, që deshe të luaje me mua, për të më provuar, pashë gjënë që ke më të shtrenjtë!

Mirela – (*në hall të dyfishtë*) Klodi, shpirt!...Mund të jetë një gabim... Pa tjetër që është gabim...Qetësohu!...Eja tek unë...Babai do të jetë kthyer.. Ai do na thotë si ishte puna..Pastaj shkojmë tek Vili...Me siguri është kthyer...(maten të dalin)

Klodi – Prit! (*therret*) Baba! Baba!(*ngjit me vrap dy tre shkallë dhe ndalon, sepse Rudi po zbrat*)

Rudi – Klodi! (*shpejton hapat*)Ç'ke kështu, bija ime?(ajo qan me dënësë) Ç'ka ndodhur, fol! (*ajo hesht, se nuk e lënë lotët të flasë*)Fshiji lotët e më thuaj ç'ka ndodhur! (*i kthehet Mirelës, po ajo ul kokën*) Mojt, po do të flisni apo si e keni hallin!...

Klodi – (*mbledh vehten*)Të lutem, baba, merre pak telefonin! Kërko hetuesinë!

Rudi – Hetuesinë?! Ç'trill të ka shkrepur në kokë?

Klodi – Pyet, përse është arrestuar Vili Rumina!...

Rudi – Si the?!

Klodi – Merre,baba!...Ty mund të të thonë diçka...Ndoshta është një keqkuptim...

Rudi – Si është e mundur,moj bijë? (*vrapon tek telefoni dhe i bie numrit*) Alo, Sandër!(*shfaqet Leta*) Hë, e përfundove materialin? Shumë mire!..Tani dëgjo! Telefonoju pak atyre të hetuesisë dhe sqaro përse është arrestuar Vili Rumina! Po, po, sot..Shpejt se po të pres!...(ul dorezën dhe vështron nga e shoqja, pastaj nga e bija)Kur ndodhi?

Klodi – Para dy orësh...Në mëngjes më përcolli deri te shkolla..E lamë të takoheshim pasdreke...

Pauzë. Rudi sillet i shqetësuar nepër sallon.Leta ngadalë i afrohet Klodit. Ajo nuk ngre kokën.Pastaj i afrohet Mirelës.

Leta – Është e sigurtë?

Mirela – Po...

Bie zilja. Rudi e merr me të shpejtë

Rudi – Alo!A, qenke ti Mensur! Jo,jo, nuk do të dal sot...Më ndryshoi mendja!(*ul dorezën. Nga dera tjetër del Nasta, që i ngjit ngadalë shkallët. Për një çast ndal dhe shikon Klodin.Bie përsëri zilja e telefonit.Rudi e rrëmben*) Alo! Hë, Sandër?(*fytyra i ngryset*) Ashtu?! Po, po e qartë...(*ul dorezën.I drejtohet Mirelës*) Është e vërtetë, bija ime...E vërtetë...Dhe e ka të rëndë...

Ajo ikën me vrap duke qarë. Klodi e instinktivisht ulet e dërrmuar në shkallë. Leta i afrohet Rudit me të shpejtë të

Leta – Përse akuzohet?

Rudi – Agjitacion e propogandë...

Leta – (*nënqesh*) Dhe ne deshëm...

Klodi – (*tërësisht e dërrmuar*)Jo, ti nuk deshe, mama...Ti ishe më largpamëse...ti sikur e kishe parashikuar, e kishe parandjerë...Po mos qesh me fatkeqsinë e tjetrit...

Leta – Edhe kur tjetri është armik?

Klodi – Tani mund t’i vesh ç’emër të duash! Dhe sonte fli e qetë, t’u realizua dëshira...Partneri im, ashtu siç dëshiroje ti, nuk doli i denjë, por të lutem tani a ka mundësi të më lesh të qetë?!

Leta – Të bezdis prania ime?

Klodi – Tani më bezdis çdo gjë...

Leta – Eja, Rudi, vajza ka nevojë të rrijë vetëm!...

Shuhen ngadalë dritat.Muzikë

Tabloja e pestë

Zyra e hetuesisë, e vendosur në paraskenë, që në fillim të shfaqjes.Në anën e kundërt është një kabinë telefonike. Hetuesi qëndron me një dosje përpara.Ulur në karrige është Vili.

Hetuesi – Pra, nuk e merrni me mend arsyen përse ju kemi thirrur...

Vili – Jua thashë që në fillim: nuk e kam fare idenë, pse humbisni kohë me mua...Ju me siguri, keni punë më të rëndësishme ...

Hetuesi – Edhe fakti që ti rri përballë meje në këtë zyrë, përfshihet në punët e mia të rëndësishme...Dhe sa për fillim, po të them, se ti je ulur në atë karrige, se të pëlqen të futësh hundët, aty ku s’të takon...

Vili – Me sa e njoh vehten, përpiqem të fus hundët vetëm aty, ku më takon...

Hetuesi – Po, vërtetë!..Me sa e njeh ti veten...Po ka të tjerë që të njohin më mirë dhe që flasin ndryshe...

Vili – Ndoshta...Po unë s’mund të mbaj përgjegjësi për gojët e të tjerëve...

Hetuesi – (me ton) Po mban përgjegjësi për gojën tënde...

Vili – Atëherë, pse s’më thoni, ç’mëkat ka bërë (për gojën)kjo e ngratë, që më solli ketu?

Hetuesi – Sepse prisja të ma thonit vetë...Pohimi që në fillim do t’ju lehtësonte...

Vili – Po çfarë të pohoj, kur nuk di asgjë?

Hetuesi – Mirë, atëherë, po ta kujtoj unë: para katër ditësh ditësh ti sëbashku me dy shokë të tu ke pirë ne bar “Riviera”Është e vërtetë?

Vili – Pjesërisht..Dy shokët e mi kanë “pirë” kafe, kurse unë hëngra një pastë...

Hetuesi – (e ndjen ironinë)Dhe duke ngrënë atë pastë, ke shprehur mendimin, se pjesën më të madhe të kuadrove tanë të devotshëm, ti nuk do ta merrje as për argat...

Vili – (vë buzën në gaz) Për saktësi, kam thënë ndonjë..

Hetuesi – E zemë, se është kështu siç thua ti, po kush të lejon të marrësh nepër gojë atë armatë të shkëlqyer të kuadrove tanë, që shkrijnë gjithë energjitë e tyre për interesin e lartë të vendit?

Vili – A nuk lexojmë për ditë në shtypin tonë kritika në adresë të paaftësisë?! Mua nuk ma do mendja, që ju nuk i besoni shtypit tonë, shoku hetues!...

Hetuesi – Po fjala “argat”, ç’do të thotë? Cilit rend shoqëror i përkasin argatët dhe për ç’qëllim përdoret kjo fjalë?!

Vili – Thjeshtë për qëllimim e një shprehje popullore...Nuk ju ka rënë rasti ta dëgjoni?

Hetuesi – (*ka filluar të nxehet*) Ti, për qëllimet e tua djallzore dhe si përhapës i propogandës së huaj, ke hedhur baltë mbi industrinë tonë, duke mohuar gjithçka, gjithçka të ngritur me mundin dhe djersën e popullit...

Vili – Nuk është e vërtetë! Kam thënë vetëm, se do të ishte mira të përfitonim më shumë nga teknologjia e përparuar botërore...

Hetuesi – Gënjen!

Vili – Shoku hetues, kontrolloni fjalët!...

Hetuesi – Ti të kontrollosh vehten e të pohosh krimin që ke bërë, i cili ka qëllim korruptimin e njerëzve tanë të ndershëm e vigilentë!..Zë një tavolinë aty e pret të peshkosh ndonjerin, për t’ia mbushur veshët me pallavrat e tua!...Por sado i djallzuar të jesh, kësaj nuk ke përt’ia arritur kurrë!...

Vili – Unë nuk jam ai që doni të më bëni, shoku hetues! Dhe jeni i pasaktë...Nuk isha unë, që i ftova ata të dy, po ishin ata të dy që u ulën në tavolinën time...Unë, bile, desha të ngrihesha, po njeri prej tyre nguli këmbë..Ishte pikërisht ai njëri prej tyre, që e hapi këtë bisedë, që për mua ishte e rëndomtë, pa asnjë ngjyrë, por që, me sa duket, ngjyra i qenka vënë mbrapa, diku tjetër ose edhe këtu...Ju lutem të jeni i saktë tjetër herë, se, edhe po s’e thashë, mund të mendoj, se edhe ju përfshihen tek ndonjeri prej kuadrove, që nuk do ta merrja as për argat...Jua thashë këtë, që të më shtohet edhe një fakt tjetër, për të më rënduar krimin...

Hetuesi – (*mezi përmbahet*) Me këtë kokëfortësi që ke e, sigurisht, me këtë gjuhë, nuk do të dalësh i larë nga kjo zyrë...

Vili – Si do që të ndodhë, unë jam aq i pastër, sa ç’janë të ndyrë të interesuarit për të më sjellë këtu...

Hetuesi – Sa je i pastër, do ta faktojme (*shtyp një buton*) Të vijë dëshmitari Kristo Mermurri!(*hyn me të shpejtë Kristo*) E njeh këtë?

Kristo – Si nuk e njoh?! Kemi qenë shokë...

Vili – Gënjen!Është e vërtetë se jemi, më falni kemi qenë në një grup.. Po jemi aq të kundërt në karaktere, sa të gjithë e dinë, se dëshmitari më ka halë në sy...Shkakun e di ai...Bile, të them të drejtën, u habita, kur m’u ul në tavolinë, por e mora si shenjë paqeje...

Kristo – Nuk jam i penduar, që nuk më ke llogaritur asnjëherë në rradhët e shokëve...(hetuesit) Kjo tregon se ai, ndoshta e ka parandjerë, që tek unë nuk i ecnin mendimet e tija armiqsore...

Hetuesi – Pra, ju dëshmoni se ai para katër ditësh ka shfaqur mendime të tilla?

Kristo – Ju përmbahem të gjitha thënjeve që kam deponuar vullnetarisht..Unë erdha vetë tek ju, sepse më rëndonte në ndërgjegje gjithë ai vrer që u derdh nga goja e tij, kundër kuadrove tanë të mbrekullueshëm, kundër ekonomisë sonë socialiste...Dhe ky, po të ketë pak ndërgjegje, duhet ta pohojë para jush të vërtetën, e cila, sado e rreptë qoftë,

duhet thënë... Megjithate, unë mund të shtoja se ato fjalë, ndoshta i ka thënë edhe nga pija...Po zaten, andej nga anët tona themi, ç'ka barku, nxjerr bardhaku...

Hetuesi – (*Vilit*)Ke gjë për t'i thënë dëshmitarit?!

Vili – Asgjë, nga ato që thotë, nuk më habit...Vetëm diçka nuk e kam të qartë.. (*Kristos*) A ka shumë kohë, që andej nga anët tuaja, pastën kanë filluar ta rradhisin në mes të pijeve alkolike?Nëqoftëse tani për tani nuk e ka të qartë përgjigjen, s'ka gjë, le të konsultohet me kë ta shohë të arsyeshme e le të ma thotë në ndonjë seancë tjetër...

Kristoja – Nuk më kuptove...Fjalën s'e pata tek pasta.. Pijen, si të thuash, e përmenda për të të lehtësuar...Mua, është e kuptueshme, nuk më vjen mirë të të shoh këtu, por duke qenë i pirë, ndoshta, mund të lehtësoheshe diçka...

Vili – Aa, më fal, s'të paskam kuptuar...Po atëherë, përse kërkove të mashtrosh shokun hetues, kur këtu duhet thënë vetëm e vërteta?

Hetuesi – (*Kristos*) Ju faleminderit, mund të shkoni!

Kristoja del. Sapo bën disa hapa, e ndalon "Ai"

Ai – E gropose?

Kristo – (*në qejf*) E groposa!

Ai – Përse?

Kristo – Sepse e kam patur në majë të hundës...Sepse shkëlqente në mësim, sepse ka një kulturë të gjërë, sepse është i pashëm, sepse më vinte të pëlçisja, ngaqë studioja si derri ditë e natë dhe, ndonëse rezultatet i kisha të mira, askush s'më vinte shenjë babazimi me të...Ohu, ka shumë sepse...

Ai – Dhe tani që të doli në shteg...

Kristo – Nuk doli vetë, ma sollën..

Ai – Kush?

Kristo – Një i panjohur, që u paraqit si punonjës i Ministrisë së Brëndëshme..Ka ca ditë...Më tha, se dyshohej për të...Se duhej të gjeja rastin, kur të isha me ndonjë shok dhe të hapja si larg e larg bisedën...Atë ditë rastësisht hyra me Shabën...Vetë iu afrova...Unë e hapa i pari bisedën... Ajo nuk dha rezultatet që prisja...Dhe unë ia tregova të gjitha atij shokut... Ai

më tha se mjaftonte kaq, veçse duheshin ndryshuar ca për hir të interesit të përgjithshëm...Se kjo bisedë nuk do të çonte shumë peshë në fajësimin e tij, por do të ishte vetëm një pretekst për ta arrestuar... Pastaj ai do të tregonte të gjitha fijet e një grupi të rrezikshëm...Më porositi të hesht, se përbënte sekretet shtetror dhe se më kishin zgjedhur mua si njeri të besuar e me perspektivë... Kaq.

Ai – Dhe ti i zbatove pikë për pikë këshillat e tij..

Kristo – Natyrisht, kur është fjala për një armik të pushtetit...

Ai – Apo tëndin?

Kristo – Edhe timin..

Kristoja largohet. "Ai" qëndron në hije

Hetuesi – (*Shabës që ka hyrë më parë*)Pra atë ditë, ky tha disa fjalë që ty të bënë përshtypje...

Shaba – Tashti..si të them...edhe ndonjë gja të madhe nuk tha kushedi...

Hetuesi – Si nuk tha?! Deponimin tënd e kemi me shkrim...Apo na ke mashtruar?! Nëqoftëse na ke mashtruar, do të përgjigjesh ti para ligjit...

Shaba – (*në hall*) Po..është e vërtetë..E keni me shkrim...Ç’është e vërteta, Vili nuk bëri mirë që shprehu ndonjë mendim...Po unë them, se mos kushedi nuk e kam kuptuar mirë e po i bie në qafë kotnasikoti...Vilin e kam pasë shok shumë të mirë...Dhe i jam borxhli...

Hetuesi – Nuk është vendi ketu për përmallime! Përgjigju shkurt: i pranon apo s’i pranon ato që ke shkruar me dorën tënde?!

Shaba – Po ...si të them...edhe i pranoj...Po prap, them, se mos kushedi nuk e ka patur me qëllim të keq...Apo jo, Vili?

Hetuesi – E rëndësishme është, që ti i pohon thënjet e shkruara me vullnetin tënd.. Sa për qëllimin na e le në dorë neve ta përcaktojmë...(Vilit) Ke ndonjë pyetje për dëshmitarin?

Vili – Jo, jo nuk kam...Le të shpëtojë, i gjori sa më parë nga ky siklet.. Është gjynah të torturohet më tepër!...

Shaba del me të shpejtë.Përpara i del “Ai”

Ai – Hë?!

Shaba – Lene, se u tregova i paburrë!...E mora në qafë, më duket!...

Ai – Po ti sikur kishe vendosur ta përgënjeshtroje dëshminë e parë...

Shaba – Nuk ma mbajti!...Ka hije të rëndë ajo zyrë...Pastaj edhe hetuesi më kërcënoi...Ç’desha që u ngatrova me këtë punë? A,Kristo,Kristo, më more në qafë!...

Ai – Pse Kristoja?

Shaba – Si pse? Po ai më tha të pimë një kafe..Ai, për shpirt të motrës!

Edhe kur u ndamë me Vilin, ai më tha: hë, e dëgjove? Unë s’kisha pa ndonjë gjë të keqe në fjalët e Vilit...Pak ma futi krymin Kristoja, si i picigjatonte gjanat ai, po e harrova atë punë...Kur, paf, më thrrasin në hetuesi! Aty ishte hetuesi dhe një burrë tjetër i gjatë...Vili asht anmik, më thanë...Ti duhet ta ndihmosh pushtetin...Nga mënyra si i sqaronin ata fjalët e Vilit, më hynë trutë e gomarit dhe e firmosa procesverbalin...

Ai – Po mbrëmë, pse nuk fjete?

Shaba – Se s’më hiqej mendja nga Vili!... Më vinte të pëlças nga inati... Bukur po ja shpërbleja nderat e tij...

Ai – Çfarë nderash?

Shaba – Po harrove sa herë më ka marrë në shtëpi? Sa orë ka humbur me mua për të më futur në tru leksionet, që s’i kuptoja? Po që u kacafyt me profesor Bektashin, kur desh të më linte kot në klasë, e harrove? E unë i harrova, pra! Bukur ta shpërbleva, o Vili! Medet që s’kam një plumb, t’ia heq vetes!...

Ai – E ç’vlen tani? Të rrofshin fjalët e bukura..Ti je frikacak, mashtrues!...

Shaba – Më thuaj, ç’të duash..E mora në qafë!(*largohen.*)

Në hetuesi

Hetuesi – Pra, tani që dëgjove dy dëshmitarët, e pranon fajin?

Vili – Jo! Njëri është maskara, tjetrit i kishin futur lepurin në bark. A keni dëshmitar tjetër?

Hetuesi – Mjaftojnë ata të dy për të të quajtur fajtor...Do të ishte në të mirën tënde të pranoje vetë dhe të nënshkruaje procesverbalin...

Vili – Nuk jam fajtor, prandaj as sot as kurrë nuk do ta pohoj një gjë të tillë...Ndërkohë ju mund të siguronit fakte sa të doni...Po përpiquni të jenë ca më të zgjuara se këto dy të parat...

Hetuesi ndez një cigare.Lokalizim dritash.Shfaqet "Ai"

Ai – (*hetuesit*) Mbaje vehten!
Hetuesi – Më nxehu, por do të më njohë!...
Ai – Është kockë e fortë...
Hetuesi – Ashtu duket në fillim, por do ta shkërmoq si misrin, e pastaj do ta bluaj, dëgjo, do ta bluaj...
Ai – Ai nuk është fajtor...
Hetuesi – Është..
Ai – Nuk është!
Hetuesi – Mua më duhen faktet..
Ai – Cilat faktet?
Hetuesi – Dy dëshmitarë të çojnë në litar!...
Ai – Kur është i bindur ai që i dëgjon..
Hetuesi – Dëshmitë e tyre janë bindëse...
Ai – I dyti është i lëkundur...
Hetuesi – Ka deponuar me shkrim.Ligjërish jam në rregull...
Ai - Po deri në ditën e gjyqit mund të ndrojnë mendje dhe të thotë tjetër gjë..
Hetuesi – Deri ditën e gjyqit mund të ndrojnë shumë gjëra...
Ai – Dale mos u ngut!Nuk është në të mirën e karrierës tënde, që të mos jesh në gjëndje të parashikosh çdo të papritur..Pra mund të mbetesh vetëm me një dëshmitar...
Hetuesi – E pastaj?
Ai – Për mungesë provash ai është i lirë, ndërsa dinjiteti yt ka marrë një të çarë të madhe...
Hetuesi – (*qesh*)Qenke budalla i madh! Kjo s'ka për të ngjarë kurrë!.. Është e thënë të mos ngjasë...Prova të tjera, kur duhet, gjinden sa të duash... Qenke naiv i madh! Nuk e kupton se fati është paracaktuar të kalbet brënda?
Ai – I gjori djalë!...

Dritat lokalizohen në anën e Vilit, i cili ka ulur kokën..I afrohet "Ai"

Ai – Nuk të duket se u tregove shumë i prerë me hetuesin?
Vili – Ndoshta...U befasova nga akuza dhe qëndrimi i tij...Ai më trajtoi si armik...
Ai – Epo, këtu nuk është bar, ku mund të pish një kafe...
Vili – E di, po më tmerroi fakti se si mund të keqinterpretohen ca fjalë të hedhura pa ndonjë qëllim të lig...
Ai – Ja, që iu vesh ai qyrk...Vetë e ke fajin...
Vili – Po çfarë, sipas teje, u dashka që gojës t' i vemë një dry të madh, që mund të hapet vetëm, kur vjen orari ibukës? Kështu thua?

Ai – Jo, ti hape, hape, kur të të teket, orar pa orar e vend e pa vend, veçse mos kërcë, kur të të përplasen turinjve copra balte, që zor se të shqiten më...

Vili – (*nxehet*)Kjo është e padrejtë! Kjo nuk është njerzore!

Ai – Uli, uli pendët!Nuk je në ndonjë tribunë nderi,po në një stol akuze..Dhe mos harro, se fati yt është në duart e këtij njeriu,që pak më parë iu përgjigje me cinizëm...

Vili – Mos duhej të ulja kokën e të numëroja goditjet?!

Ai – Të gjeje mënyrën për ta bindur, se para tij nuk ishte ai që i kishin serviturur...

Vili – Nuk më dha rast..

Ai – Dhe ti, i pagabueshmi, i drejti, parimori nuk i lëshove asnjë fije pe...

Vili – Do të ishte në dëmin tim...

Ai – Ende vazhdon të luash heroin?Pse harron, se je si të gjithë të tjerët, se duhej të fitoje simpatinë e tij dhe jo t'i hidhje benzinë zjarrit? Prap nuk e merr vesh, se mund të dënohesh?

Vili – Të dënohem? Po si mund të dënohet kaq lehtë një i pafajshëm?!

Ai – Sepse janë dy dëshmitarë, që vertetojnë të kundërtën..

Vili – Po kjo është e tmerrshme!Të dënohem, pse u pëlqen dy vetëve të shpifin? Po atëherë, çdo njeri mund të ketë dy armiq, që fare thjeshtë i përgatitkan varrin!Jo, jo, nuk është kështu!Nuk duhet të jetë kështu!...Si mund t'i besohet qorrazi një maskarai si Kristoja?

Ai – Nuk ishte vetëm Kristoja..

Vili – Edhe Shaba...Ai s' duhej ta bënte këtë...Apo dikush ia ka zënë bishtin me derë...Nuk e dallove, si i vinte zor të më shihte në sy? Hetuesi e kërcënoi...

Ai – Domethënë...

Vili – Çfarë domethënë?

Ai – Po të përgatitet gjyqi!

Vili – Se jam fajtor, apo dikujt i intereson të më bëjë të tillë...Po kush mund të jetë?Të lutem më thuaj, kush mund të jetë ai, që më paska ruajtur në pritë?!Dhe përse? Ç'të keqe i kam bërë?Të lutem më thuaj një fjalë, se po luaj mendsh!

Ai – Asgjë nuk di saktë...di vetëm që je i humbur!...

Vili – Ke të drejtë...Jam i humbur!...I humba të gjitha..M'i shembi orteku! Një ortek i beftë dhe i pamëshirshëm, që nuk e marr vesh, nga dhe pse më shembi kështu mizorisht ...Nënë!Baba,vëllaçko, motra të dashura! Klodi!Miq!Vili ka humbur! Dëgjuat?Ka humbur! Do t'ia harroni ngjyrën e syve kur të dalë që këndeje! Ka humbur!
në jehonë përsëritet "ka humbur, ka humbur"

dritat

Tabloja e gjashtë

Në paranskenë. Një kabinë telefoni. Në këmbë qëndrojnë Vasfiu dhe Lumja. Vasfiu pi cigare në ethe.

Lumja – Hë, ç'pret, do ta marrësh atë dreq telefoni, apo ta marr unë?

Vasfiu – Nuk më bën dora...Si mund të kërkoj prej atij, që mund ta kisha krushk, të ndërhyjë për një gjë të padrejtë?!

Lumja – Prap me të tuat ti? Nuk e kupton se luhet me jetën e djalit tënd?

Vasfiu – Mund të jëtë fajtor...

Lumja – Asgjë nuk dimë..

Vasfiu – Diçka dimë...Mirela tha...

Lumja – Ndoshta është një keqkuptim...Shoku Rudi mund ta sqarojë. Neve s'na e var njeri..Atij po..Të paktën, të marrim vesh diçka..Hë, Vasfi, të keqen, merre telefonin! Merre, se po çmendem!..

Vasfiu – Nuk mundem..Nuk mund t'i vë një borç..Nëqoftese Klodi..

Lumja – Klodi është Klodi, ne jemi prindërit e tij...Ne duhet të bëjmë diçka..Nuk është jetim...Edhe shoku Rudi njeri si ne është...Bile, thonë, njeri i mirë...Nuk e ke dëgjuar Mirelën ,që hyn e del në shtëpinë e tyre, se si flet për të? Nuk ta merr për të keq, ta them unë!...Po edhe sikur ta marrë, ç'humbëm? Njëherë për një herë mua më duhet djali..Asgjë tjetër, s'më hyn në sy...Hë, si thua, do ta marrësh?!

Vasfiu – (në mëdyshje) Harrova numrin!...

Lumja – (Nxjerr nga xhepi një letër) E kam të shkruar..Ja, ku është!. Hë, të keqen, merre!

Vasfiu – Po, çfarë t' i them, moj Lume, se jam Vasfiu? Po ai nuk me njeh!Ç' do të mendojë për një njeri, që nuk ka këmbyer asnjëherë dy fjalë me të dhe as fytyrën nuk ia di si e ka, që i vë përpara një borç të rëndë? Se është diçka e rëndë të shtysh tjetrin për diçka të paligjësme..Ja, do të thotë, pa u lidhur mirë miqësia, filluan të më shfrytëzojnë postin...Dhe nuk i vë faj!...

Lumja – Atëherë ruaj hundën tënde dhe lëre djalin në mëshirën e fatit!

Vasfiu – Nëqoftese nuk ka bërë faj, do të dalë shpejt...Nuk është i vogël...Ashtu siç di t'i japë xhevap kujtdo qit e prit, le ta mbrojë vehten... Nëqoftese ka shkelë në dërrasë të kalbët, le ta mbajë vetë barashkën!...

Lumja – Kaq shpejt po e mohon?

Vasfiu – Nuk e mohoj, se është gjaku im e më ther fort, ti e di mirë...

Lumja – Atëherë ç'të pengon të bësh diçka për të?

Vasfiu – (në hall)Po të dëgjoj me veshët e mi atë, që s'dua ta dëgjoj kurrë, do të më vdesë edhe ajo shpresë e vakët...E kupton tani, pse s'më bëjnë duart të marr atë telefon?

Lumja – Nuk është vetëm kjo, të njoh mirë..

Vasfiu – Edhe nuk dua të lëpihem...Askujt nuk i lëpihem për të fituar diçka, se pastaj gjithëmonë tjetri të sheh me atë sy...Kush don të të bëjë nje nder, ta bën pa i rënë në qafë...Aq më tepër në rastin e Vilit, që tashmë u përket dy familjeve...Pse duhet t'i lutem për djalin tim, në qoftese ai s'ka ndërmend të shtyhet për dhëndrrin e tij?

shuhen dritat.Kur ndezen, jemi në shtëpinë e Rudit. Klodi e ulur në njërin nga karriget e verandës, ka vënë duart në kokë, e qan në heshtje... Nga shkallët zbret Rudi, që si e dallon i afrohet ngadalë. Edhe ajo e sheh, po s'luan nga vendi. Rudi i ledhaton flokët

Rudi – Prap ti? Pse me lot do ta gjesh zgjidhjen?!Ke dy ditë, që as ha, as pi, veç qan...Nuk bën kështu! Asgjë nuk zgjidhet kështu...Ajo që ndodhi, ndodhi...

Klodi – Po pse ky ndëshkim, baba?

Rudi – Nuk jam në gjendje të jap përgjigje...Jam i tronditur po aq sa ti!...

Klodi – Nuk ka asnjë shpresë? Asnjë rreze dielli?

Rudi – Nuk di...Nuk shoh ndonjë...

Klodi –(Befas) Një fjalë e ytja mund ta shpëtojë...

Rudi – Këtë mos ma kërko, bijë e dashur...Ligji vepron mbi këdo...

Klodi – Po ligji duhet të jetë njerëzor, baba! Dhe ai mund të interpretohet gjithësesi...

Rudi – Ligji është ligj dhe para tij jemi të gjithë të barabartë...Si mundet, që unë të kërkoj shkeljen e tij? Jo, bijë, nuk e bëj dot, më kupto!..

Klodi – Duhet ta bësh për mua, për atë zog të mjerë, që përpëlitet këtu brenda meje me krahë të prerë, me zë të shuar, kur qe bërë gati të këndonte aq këngë...Njëherë e një kohë edhe ti ia ke dëgjuar këngët... Janë aq të bukura, aq të brishta! Nuk të vjen keq që vajza yte nuk do t'i dëgjojë më?

Rudi – Ti je e re..

Klodi – Ato dëgjohen veç një herë në jetë...Gënjen vehten ai, që mendon ndryshe...

Rudi – Je vetëm tetëmbëdhjetë vjeçe..Mbase është shpejt të japësh një konkluzion të tillë...

Klodi – Mbase, po unë nuk jam një budallaçkë...

Rudi – Pse je e mençur, duhet të gjykosh si e mençur...Jo gjithmonë njeriu të del ashtu siç e mendon...Ekziston edhe zhgënjimi...

Klodi – Duhet jetë një keqkuptim...Vili nuk është...

Rudi – (e ndërpret) Se ç'është e dinë vetëm ata, që merren me të...

Klodi – Ti duhet ta shpëtosh! Më beso, ai kurrë nuk mund të bëjë një ligësi...

Rudi – Pse të besova, isha ai që të dhashë bekimin i pari..

Klodi – E di, baba, prandaj të lutem ta çosh mirësinë tënde deri në fund! Bëje për mua, për gazin tim, për jetën time...Zëre se jam unë në vend të tij...

Rudi – Edhe ti po të ishe...

Klodi – Mos gënje veten,baba! Po të isha unë, ti do të pëtmbyesje malet...Përmbysi edhe tani! Ti je i fortë!...

Rudi – Nuk mundem...

Klodi – Mundesh...Më qëndro deri në fund një aleat i mirë, baba!

Rudi – Për ç'aleat e ke fjalën?Më kishe të tillë, kur nuk qe kjo bombë që përmbysi gjithçka...Tani s'më ke më! Kjo është jashtë mendjes! Ti më kupton drejtë, besoj...Madje, po të flas sinqerisht, tani po më çudit edhe ime bijë me këmbënguljen e saj...Po ime bijë mos është verbuar, mos i ka humbur arsyeja? Në raste tilla prishen familje, kurse ime bijë,që as germën e parë të alfabetit të jetës nuk e ka shkruar mirë, siç duhet, ngul këmbë në të sajën...Unë isha ai, që t'u bëra krah, unë jam tani kundërshtari më i zjarrtë! Nuk shkohet qorrazi kështu, siç shkon ti, se diku do të përplasesh, në mos më keq.. Plaga yte është edhe plaga ime...Po ajo është plagë e cektë dhe, megjithëse tani mund edhe të të dhëmbë, pas ca kohësh do të mbyllet pa lënë asnjë gjurmë...Këtë ta lehtëson edhe zhgënjimi!..Ndryshe do të ishte, po të kundërshtonim pa asnjë shkak...

Klodi – Ke të drejtë, baba, shkak është i prekshëm...

Rudi – Mbase fola ca si ashpër, por e vërteta duhet thënë siç është...Shkova tani, se kam një qerre punë...Ti përpiqu ta harrosh atë që ndodhi, poqë na trullosoi të gjithëve...Nesër lind mëngjes i ri...

Klodi – Të cilin Vili do ta presë prap në qeli...(me zjarr)Ai duhet të shpëtojë, baba!

Rudi – Nuk mund të bëj asgjë bija ime!

Klodi – *(pauzë muzikore)* Nuk mundesh, edhe sikur unë të flijoj këtë zog të mjerë?

Rudi – *(hesht për një çast)* Nuk mundem...

Klodi – As para kësaj sakrifice baraz me jetën nuk thyhesh, baba? Atëherë nuk më paske njohur mirë!... *(shpërthen)* Me këtë çmim të rëndë unë paguaj vetëm shpëtimin e tij!...Përndryshe, mos më llogarit në anën e atyre që prishin familjet në raste të tilla...Unë do të pres pa u lodhur, pa m'u fikur asnjë grimë ndjenja për të, përkundrazi, duke më djegur më shumë, duke më përvëlur më shumë, pesë vjet, gjashtë, shtatë, tërë jetën...Madje, kjo do të ishte më e lehtë, se kurhani im i mjerë, se çmimi që i caktova këtij pazari... Në se pranon, atëherë unë jam aq e fortë, sa zemrës ti vë gurin përsipër...Të paktën, kjo ndjenjë sublime, që fati i keq i parashikoi jetë kaq të shkurtër, u sakrifikuva t'i lehtësojë vuajtjet atij, që iu përkushtua...E pranon kontratën, baba?

Rudi – Vërtetë nuk të paskam njohur!...

Klodi – Tani që më njohe, ç'thua?

Rudi – Do të përpiqem...*(Klodi nis të dalë)* Po tani ku shkon?

Klodi – Kam nevojë të dal pak...

Rudi – Prit, dalim bashkë!...

Klodi – Dua të jem vetëm...*(largohet)*

Leta - *(del nga dhoma)* Hë?!

Rudi – Më duket se fituam! Tani është maj...Në gusht i pres biletën e avionit...Pastaj gjithçka do të harrohet...

Leta – Ç'qe kjo mrekulli e qiellit?!

Rudi – *(nënqesh)* E qiellit?!Po shkoj në studio..Mos më shqetësoni për asgjë...Po të vijë Sandri, sille tek unë!...

Leta e ndjek Rudin tek ngjitet shkallëve për në katin e dytë.Muzikë

dritat

Në hetuesi. Hetuesi rri në këmbë e pi cigare mendueshëm. Shtyp një buton.

Hetuesi – Vili Rumina!*(ulet në tavolinë dhe hap dosjen.Hyn Vili.)* Ulu! *(Vili ulet)*
Ke reflektuar ndopak, para se të vije në seancën e sotme?

Vili – *(getë)* Jam përpjekur, por nuk arrij të kuptoj asgjë...

Hetuesi – Nuk është në të mirën tënde të mohosh me kokëfortësi atë faj të qartë si drita e diellit, që unë do ta vertetoj edhe me fakte të tjera...

Vili – Shoku hetues, ju pyes sinqerisht,vërtetë nuk e kuptoni, se para jush keni një të pafajshëm, të cilit dikujt i ka interesuar ta sillte këtu?! Ju lutem, çvishuni për një çast nga detyra që ju kanë ngarkuar dhe flisni si njeri dhe si profesionist...

Hetuesi – Edhe njeriu, edhe profesionisti më thonë të njëjtën fjalë:
fajtor!

Vili – Atëherë qenka fatkeqsia ime, që s'paskam rënë as tek njeri e as tek tjetri!...

Hetuesi – *(nxehet)*Do të përgjigjesh edhe për këtë fyerje!...

Vili – *(getë)*Gaboheni, një ditë do të përgjigjeni ju!

Bie zilja e telefonit. Hetuesi i nxehur si çështë e merr me të shpejtë.

Hetuesi – Alo! (*i ndryshon toni*) Mirë ju faleminderit shoku... (*paузë*) Sipas të gjithave provave të pakundërshtueshme, është fajtor!... Urdhëro?! (*përtypet*) Më falni, nuk iu kuptova... (*paузë*) (*me gjysëm zëri*) Ashtu?! Meqë thoni ju...

Muzikë. Hetuesi ul dorezën e telefonit. Ngrihet. Ndez një cigare. Shkon tek makina e shkrimit dhe heq fletët. I merr në dorë dhe i afrohet Vilit duke e parë drejtë, me ca sy të egërsuar, thua se do ta shqyejë, por përmbahet. Me një nënqeshje të hidhur fillon të grisë ngadalë fletët e procesverbalit.

Vili – Ç'po bëni?! (*hetuesi nuk i kthen përgjigje*) Nuk jeni mirë, shoku hetues... E shtyejmë seancën për një herë tjetër...

Hetuesi – (*mbledh veten*) Nuk do të ketë seancë tjetër... (*i gris në mënyrë demonstrative fletët*) Jeni i lirë! (*muzikë*)

Vili – Ju kenë nevojë të pushoni, shoku hetues... Unë pres...

Hetuesi – Nuk më dëgjuat?! Që në këtë çast jeni i lirë!... Mund të shkoni...

Vili – Jo, nuk është e mundur! Gaboheni... Dy minuta më parë për ju unë isha fajtor, i pandehur, armik... Si mund të zhvishem kaq papritur nga tërë këto attribute?

Hetuesi – Ju zhvesh ky procesverbal i grisur... Ato fjalë nuk ekzistojnë më...

Vili – Në letrat tuaja?! Po ç'ëndësi kanë për mua letrat tuaja? Me një të lëvizur të dorës ju kujtoni, se më kthyet atë që më kishit rrëmbyer hajdutërisht?! Gënjeni veten, zoti hetues... Letrat vërtetë i grisët e në vend të tyre ju fare mirë mund të shkruani të tjera, po a mund të grisët kaq lehtë dinjiteti im i përdhosur, i fyer, i rënduar nga tërë ajo baltë, që iu hodh pamëshirë? Më thoni, si mund të shkatërrohet kaq lehtë e në vend të tij të montohet një tjetër? I ç'marke është, i ç'viti prodhimi është, kush është konstruktori, a bën ta di?! Po cili është ai mjeshtër që do të jetë në gjëndje të ma montojë pa ndjerë dhembje, pa më therur qoftë edhe një nerv e pa më plasur një kapilar?! Jo, zoti hetues, nuk është e mundur!...

Hetuesi – (*që ka shtangur*) Unë nuk thashë se jeni i pafajshëm, unë thashë, se jeni i lirë...

Vili – Aq më keq! Ju padrejtësisht po shkelni ligjin... Po e shkel ligjin një mbrojtës i ligjit!. Kjo është e pafalëshme! Mos u shtyni deri këtu për mua, zoti hetues, përndryshe ligji do të veprojë mbi ju...

Hetuesi – (*i dërrmuar*) Ligji njeh edhe rrethana lehtësuese... Nuk është i ngurtë... Vetë sjellja juaj e mëparëshme, biografia e mirë pa asnjë njollë, kushtet familjare... Të gjitha këto...

Vili – Ku ishin fshehur pak më parë të gjitha këto? Pse dolën kaq papritur e pa kuptuar të gjitha këto, që vetëm pak çaste më parë i kishte përpirë lugati?! Jo, zoti hetues! Ishte pikërisht ajo telefonatë magjike, që ua serviri befas... Një telefonatë bamirëse, që përmbysi gjithçka... Po, vallë, a mundet kaq shpejt ai zë i çuditshëm, të fshijë nga faqja e dheut këto netë të tmerrshme, që kaloi një familje e thjeshtë, në një shtëpi të thjeshtë diku në periferi?! A mundet tua rikthejë, ta ribëjë, siç ishte më parë, shpirtin e tyre të coptuar nën vështrimet kurioze, dashamirëse apo dashakeqëse të kureshtarëve përreth?! A e ka atë forcë sa t'i heqë thinjat e reja të këtyre netëve një puntori të ndershëm, që kushedi nën ç'makinë e ka mbështetur kurrizin, apo një tezgjahisteje shpirtmirë, që kushedi, nga

hutimi apo turbullira duart e shtrenjta mund t'i kenë përfunduar në ingranazhet e makinerisë? Atëherë, si mund të dal i qetë nga ky vend?!

Hetuesi – Gjithëçka do të harrohet...Ju duhet të dilni!...

Vili – Unë të dal kështu? Jo, kurrë!..

Hetuesi – Ju po më habisni!Nuk kam ndeshur asnjë rast të ngjashëm... Një tjetër do të falenderonte dhe do t'ia mbathte me të të katra...

Vili – Një tjetër mbase. po, unë jo!Tani jo!Prej këtu dal vetëm me një kusht!(*Hetuesi e sheh me shpresë se më në fund po përfundon kjo torturë*) Që ju të uleni në vendin tim!

Hetuesi – (*i befasuar*) Unë?!

Vili – Në fillim ju që shkelët ligjin, pastaj ajo telefonata e pushtetëshme që përmbysi gjithçka...

Hetuesi – Ju duhet t'i jeni shumë mirënjohës asaj telefonate!

Vili – Ashtu mendoni? Po ç'ti bëj kësaj kokës time çapraze, që rri e gatuan ca mendime të tjera?A do t'ua them njerin prej tyre?(*lehtë, me të tallur*) Po ta them në konfidencë: ai shoku çudibërës që brenda disa sekondave të urdhëroi të lëpish pa tekëlif, atë ç'kishe vjellë për kaq kohë, që ligjin paska forcë ta përtypka si karramel, tjetër gjë të ka urdhëruar pak ditë më parë...Arsyen mund ta dijë ai, po mund ta marr me mend dhe unë... Bile, mund të marr me mend edhe gjëra të tjera, që shkojnë ca më larg... Po këtë më fal, hë për hë, nuk mund të ta them...Doni që unë të dal? Uluni në karrige turpi!

dritat. Muzikë alarmante...Zile të vazhdueshme telefonash. Sirena e një sirene makine policie.

Ndriçim i pjesshëm i sallonit të shokut Rudi, ku në këmbë qëndron ai përballë Sandrit

Sandri – Ju duhet të më kuptoni, shoku Rudi...Ai është i rrezikshëm!.. Hetuesi ishte i alarmuar! Djali ka shprehur mendime kërcënuese!. Po të dalë që andej, ju e kuptoni se ç'mund të ndodhë...

Rudi – Po të mbetet brenda, humbas vajzën..Mendo një rrugëzgjdhje!

Sandri – E kam menduar!Shoku Rudi, a ka ndonjë njeri normal, që do të refuzonte të dilte i larë nga hetuesia?Unë mendoj se nuk ka! Pra, reagimi i tij është kryekëput anormal dhe tregon, se kemi të bëjmë me një njeri të çmendur...Mos duhet lënë i lirë një i çmendur, kur ka mjekë që paguhem për këtë punë? Mjafton një diagnozë dhe ai mund të kurohet për ca muaj në një psiqiatri...Vajza juaj, nuk ma do mendja, se do të ketë dëshirë të humbasë Parisin për një të çmendur...Duhet gjetur një mjek!...

Rudi – (*nënqesh*)Të thërritet nga hetuesia doktor Ylli! Një që ka humbur shpresën, mund të fitohet më lehtë, kur të shohë rivalin në duart e tij...Bukur të ka shkuar në mendja...Në çmendinë!(*qesh me vehte*)

Sandri del. Rudi rri një çast meditues dhe herë herë tund kokën, thua se flet me vete. Matet të ngjisë shkallët. Shfaqet "Ai"

Ai – Prit, ku shkon!

Rudi – Në studio, ku tjetër?

Ai – Nuk e mbarove ende studimin për qeverinë?

Rudi – Sonte e mbaroj...Më duhet të marr ca veten, se më ndërpreu Sandri...

Ai – Pra, sonte e mbaron!...Domethënë se tani do të mbyllesh në studio deri në mesnatë...

Rudi – Po...

Ai – Dhe do të punosh i qetë?!

Rudi – Sigurisht...Edhe nata është e qetë...

Ai – Nuk ka se si të punosh i qetë pas atij vendmit, që morët...

Rudi – Qenke budalla!Mos duhet të mbaj zi?

Ai – Domethënë, për ty nuk ka ndodhur asgjë, që të prishë rrjedhën normale të jetës...Sonte do të studiosh, pastaj do shtrihesh të bësh një gjumë për shtatë palë qejfe; nesër, si zakonisht, i përpiktë në orar, do të bësh humor me vartësit,dikujt do t'ia heqësh veshin për shkelje të disiplinës, një tjetrit mund t'i bësh një premtim, pastaj mbledhja e qeverisë, përgëzimet për studimin e vyer në interes të popullit, telefonatat në mungesën tënde dhe

letrat që kanë ardhur nga baza; do të mbash shënime gjithnjë në të mirë të popullit e kështu deri pasdreke...Do të dalësh i fundit nga digasteri dhe do të ndeshesh, si zakonisht, në sytë e çuditur të shoferit, që sikur të thonë: po mbyte veten në punë, o shoku

Rudi!...Kështu?

Rudi – Pikë për pikë kështu!

Vili – Dhe nuk do të të bjerë fare ndër mend se në një pavion të spitalit psiqiatrik është bërë gati një shtrat për një djalosh me emrin Vili, që diku e ke dëgjuar, apo të duket se e ke dëgjuar!...Se për disa kohë ky djalosh, nën kujdesin tënd e të vasalëve të tu, mund të çmendet vërtetë rrethuar prej të çmendurish?

Rudi – Sigurisht që më vjen keq, po para së ardhmes së Klodit, kushdo tjetër është një hiç...Ajo është drita e syve të mi dhe unë nuk mund të lejoj të verbohët...Për dy – tre muaj atë e pret Parisi, Sorbona, Notre Dame, Luvri, Pale Ruajal, Harku i triumfit...

Ai – Po atë varfanjak ç'e pret?

Rudi – Nuk është faji im, se m'u ngatrrua nepër këmbë...

Ai – Dhe ti e shtype pa mëshirë...

Rudi – Fati i tij i keq...

Ai – Shpirti yt i keq..

Rudi – (*kujtohet*)Pa dale njëherë, kush qenke ti, që më bën gjyqin? Si guxon të m'i thuash këto fjalë?

Ai – Mos do të më vrasësh edhe mua? Gënjen veten, mua s'më vret dot!

Rudi – Po kush je ti, xhanëm dhe si hyre ketu?

Ai – Hyra dhe do të hy, kur të më teket...

Rudi – Dil përjashta!

Ai – Nuk dal!

Rudi (*therret i tërbuar*) Përjashta!Përjashta!

Ai – Jo, do të vi pas...

Rudi – (*therret*) Nasta! Nasta, moj!(*ajo del me të shpejtë*)

Nasta – Urdhëro, Rudi! Nuk ka ardhur ende koha e kafesë...

Rudi – Në djall shkofsh me gjithë kafe!...(Nasta *mpihet*)Përse e ke lënë derën hapur?

Nasta – (*i hedh një sy*)Mbyllur është Rudi!...

Rudi – Po, atëherë, nga hyri ky, nga dritarja?

Nasta – Kush hyri, Rudi? Askush nuk hyri...
Rudi - Mos të kanë plasur sytë? Nuk shikon?!
Nasta – (*vështon përreth*) Jo, Rudi, këtu nuk ka njeri!...Ulu pusho, je lodhur... Ja, po ta sjell tani kafënë!...

dritat

*Hetuesi është ulur në karrigen e tij e lexon diçka.Zilja e telefonit.
E merr.*

Hetuesi – Shumë mirë, futeni brenda!(*ndez një cigare.Hyn Ylli*) Urdhëroni, doktor!
Ylli - Ku është i sëmuri?
Hetuesi – Po e sjellin...Ju do ta shihni vetë! Është tepër i çuditshëm..
Ylli – Kështu, më thanë..
Hetuesi – E kishim arrestuar për agjitacion e propogandë, por që në fillim e kuptova, se kisha të bëja me një njeri anormal...I flisja me të butë, ai më mbante fjalime..Për çfarë do të thoni ju? Që nga kometat e deri tek llojet e zogjve...Në fillim mendova, se mos ishte një simulant, deri sa u binda se ai kishte lajthitur..Tema e tij e preferuar janë milingonat...Pastaj fill papritur kujtohej e thoshte broçkulla, sikur njerëz të rëndësishëm e kishin pasë halë në sy kapacitetin e tij mendor, ndaj e kishin sjellë aty...Një e dy më pyeste, kush isha, përse e vështroja ashtu, a kishte njeri pas dere,që na dëgjonte, shkante te dritarja e vështronte përjashta, pastaj ulej me të shpejtë e thërriste, “ik, largohu, pse me ndjek?” Dje i thashë, se do ta nxirrim, por nuk pranoi...Jam mirë këtë, më tha...Përjashta është ai...mbrëmë isha për darkë, te një miku im...Se si u hap biseda dhe i tregova.Ai më sugjeroi t’ju thërrisja..Ju njihte..
Ylli – E keni fjalën për shokun Sandër?
Hetuesi – Pikërisht..Ju paska takuar?
Yll – Ma sillni të sëmurin dhe na lini vetëm..
Hetuesi – Ju nuk keni, pse e zgjatni..
Ylli – Sa të bëj një formalitet..
Hetuesi del. Ylli ulet në vendin e hetuesit. Pas pak hyn Vili.Sapo e shehYlli ngrihet përnjëherë në këmbë i befasuar, po e mbledh veten dhe ulet qetësisht.Vili ia ngul sytë dhe rri në këmbë
Ylli – Ç’bën këtu? Përse nuk ikën?!
Vili – Pse të ik?Këtu është shumë mirë..
Ylli – E po, meqenëse të pëlqen, ulu të bisedojmë..
Vili – Ku të ulem?
Ylli – Aty pranë ke një karrige...Mos ki frikë, të mban!
Vili – Në këtë karrige nuk ulem..
Ylli – Mos ke dëshirë të këmbejmë vendet?
Vili – Po..
Ylli – Mirë, urdhero këtu!..*(ndrojnë vendet)*
Vili – Atëherë fillojmë, përse ke ardhur këtu?
Ylli – Më sollën..
Vili – Pse ç’faj ke bërë?
Ylli – Mblodha një grusht milingona...I dua shumë...Po ti?

Vili – Mua më dhimsen...Janë shumë të urta e punëtore, po kushdo mund t'i shklasë me këmbë...

Ylli – Qenkemi njëlloj..Mua më quajnë Ylli...

Vili – Mua Vili!Ke dëgjuar për mua?

Ylli – Kam dëgjuar, si s'kam dëgjuar! Gëzohem që të njoh!..

Vili – Pse, për herë të parë më sheh?

Ylli – Po..Dhe më vjen keq, që s'të kam njohur më parë...

Vili – (*ngrihet*)A është e vërtetë, se lakra ka shumë fitinë?

Ylli – Nuk e di...

Vili – Të rekomandoj të hash sa më shumë lakra!Po të hash shumë lakra,siç kam ngrënë unë, do të mbash mend më mirë...

Ylli – Të faleminnderit për këshillën..Do të ha...

Vili – Përse ke ardhur?

Ylli – Të thashë, pra...

Vili – Mos u shtirni! Ju keni ardhur, apo ju kanë sjellë, që të vertetoni, se para jush qëndron një i sëmurë psiqik..Apo jo, doktor?

Ylli – (*Pranon*)Po..Nuk e dija për kë bëhej fjalë...U trondita, kur të pashë...

Vili – Po kush të solli, Sandri apo shoku Rudi?

Ylli – Ç'rëndësi ka?

Vili – Mos ma thuaj...Vërtetë nuk ka rëndësi...Po pse të zgjodhën pikërisht ty?

Ylli – Jam specialist...Përse akuzohesh?!

Vili – Për vjedhje...Hyra gabimisht të marr një frut të ndaluar në një kopësht të ndaluar...

Ylli – Vetëm për këtë?

Vili – Pak të duket? Po si mund të përfundonte ky frut në gojën time, që ishte mësuar me lakra?!

Ylli – Një gjë nuk po e kuptoj, përse ke besim tek unë që m'i thua këto fjalë?Mua më kanë sjellë të të përcaktoj diagnozën...

Vili – Më ka folur Klodi...

Ylli – Të ka thënë që e kam dashur?

Vili – Jo, ajo më ka thënë, se ju vlerëson si një mik të mirë, por në atë mbrëmje, kur ju po vallzonit, unë mendova se ishte më shumë se miqësi, të paktën nga ana jote...

Ylli – Kurse unë që atë natë kuptova, se çuditërisht fitove ti.. Të pata zili, se arrite të përdorësh me mjeshtri atë armë, që unë nuk e përdora asnjëherë, indiferencën...Nejse, s'është vendi tani të kujtojmë...Si mund të të ndihmoj?

Vili – A nuk po më ndihmon me këtë bisedë?

Ylli – Kjo është një hiç!Ti duhet të dalësh që këtu!..

Vili – Si të dal,i poshtruar?

Ylli – Rëndësi ka të dalësh njëherë..

Vili – Më thanë, po nuk pranova...Nuk pranova, se arrita të kuptoj gjithçka...Nuk ishte puna për të më thyer mua, po dikë tjeër...

Ylli – Klodin...

Vili – Po..

Ylli – Ndofta nxitohesh në përfundim...Klodi është vajzë me karakter..

Vili – E ku ka karakter që i bën ballë një rrebeshi të tillë?

Ylli – Po ja ti, përshembull...

Vili – Kam gënjyer veten...Doja të shfreja, t'i poshtroja, të dridheshin ca, sepse e ndjeva që Klodin e kisha humbur...Po të mos qe thyer ajo, nuk do të më thonin, se isha i lirë...Pastaj, kur parandjenë rrezikun, të sollën ty...Ti nuk mendon kështu?

Ylli – Po unë s'kam pët ta bërë kurrë, një gjë të tillë!

Vili – Shpejt do të gjindet një tjetër në vendin tënd...

Ylli – Unë nuk do të hesht...

Vili – Dhe do të vish prap në këtë zyrë, por jo si mjek... Të lutem, shkruaje diagnozën!..Midis të sëmureve do ta ndjej veten më të qetë...Do zoti, qëlloj në pavionin tënd!...

Ylli – Më fal, po këtë nuk mund ta bëj!..Mos do që unë të flas me Klodin?

Vili – Jo.Ajo mund të më kërkojë vetë po të dojë..Si thua Ylli, cila diagnozë më shkon më shumë për shtat.(*Ylli i revoltuar shtyp butonin. Hyn hetuesi dhe një roje që merr Vilin, që para se të dalë, i drejtohet Yllit*) Brumbujt e grerëzat i kam shumë inat!Të gjitha do t'i shtyp një e nga një... (*del*)

Hetuesi – Hë, doktor, nga se vuan?

Ylli – Ai është më normal se unë dhe ti!

Hetuesi – Ashtu? Ju gaboheni, doktor!Po ç'gjëra të mençura të tha gjatë bisedës?

Ylli – Shumë...Po për ju nuk paraqesin interes...Ju mund të vazhdoni normalisht hetimin...

Hetuesi – Jo, doktor, ne nuk mund të mbajmë këtu një të çmendur, sepse ai është një i çmendur dhe një i çmendur e ka vendin në çmendinë! Në mos keni qenë ju i aftë ta njihni, duhet te jeni i aftë që të tregoheni të paktën i matur, kur të dilni që këtu dhe në të ardhmen...Dhe të studioni më shumë, doktor!...

Ylli – Ju faleminderit për këshillën! Do të përpiqem...A mund të shkoj?

Hetuesi – Dhe të na falni për shqetësimin! Kur ta shihni në mes të pacientëve tuaj, ju lutem të tregoni kujdes për të...Natyrisht, po të jeni aty...

(*Ylli del i revoltuar.Hetuesi merr dorezën e telefonit*)Alo, shoku Sandër! Duhet gjetur një mjek tjetër!

Shuhen dritat. Muzikë alarmuese e tronditëse.

Një holl apo ambjent spitali.Vili i ulur në një cep rri i menduar. Në tërë gjatësinë e paraskenës luhet "Vallja e të çmendurve" Ata i afrohen, i sillen përqark.Vili vë buzën në gaz, herë e largon ndonjërin.

Në cepin tjetër shfaqet Klodi.Vallja spostohet nga ajo. Ajo largohet, ata e ndjekin nga pas...Dëgjohet zëri i Klodit si nga humnera "Vili-iiii!" Shuhen dritat ngadalë...Një uturimë avioni dhe zëri i spikerës së aeroportit në mikrofon: Vini re! Vini re! Avioni i linjës Tiranë Paris, porta 2. Ju lutemi udhëtarëve të bëhen gati! Flight to Paris gate 2.Passangers are reminded to keep their luggage with them at all time!

Përsëritet prap në sfumim e sipër... Muzikë.

dritat

